


Të fotokopjueshme
Të fotokopjueshme
Të fotokopjueshme
Të fotokopjueshme
Të fotokopjueshme

Loja dhe
të Nxënët
në Moshën
e Hershme

STRATEGJI TË PROVUARA DHE TESTUARA

- Të kuptuarit e nevojave individuale
- Ndërtimi i burimeve dhe bankës së ideve
- Strategji që funksionojnë në praktikë



Loja dhe të Nxënët në Moshën e Hershme

Një Metodë Gjithëpërfshirëse



**Strategji të Provuara
dhe Testuara:
Loja dhe të Nxënët
në Moshën e Hershme**

Tituj të tjerë të kësaj serie:

Sjellja në Fëmijërinë e Hershme
1-84312-104-2

Eliminimi i Pengesave në të Nxënë në Fëmijërinë e Hershme
1-84312-338-X

Përgatitja e Shkrimit dhe Leximit në Fëmijërinë e Hershme
1-84312-337-1

**Strategji të Provuara
dhe Testuara:
Loja dhe të Nxënët
në Moshën e Hershme**

Një Metodë Gjithëpërfshirëse

Angela Glenn,
Jacquie Cousins dhe
Alicia Helps



LIBRARI E KUTISËS SË SHKOLLËS



David Fulton Publishers Ltd
The Chiswick Centre 414 Chiswick High Road, London W4 5 TF

www.fultonpublishers.co.uk

Favid Fulton Publishers është një nënndarje e Granada Learning Limited, pjesë e ITV plc.

10 9 8 7 6 5 4 3 2 1

Copyright © Angela Glenn, Jacquie Cousins dhe Alicia Helps 2006

Biblioteka Britanike Katalogimi i të dhënave të publikimit

Një regjistrim i kataloguar për këtë libër është bërë nga Biblioteka Britanike

Shënim: të drejtat e autorësisë të Angela Glenn, Jacquine Cousins dhe Alicia Helps për këtë vepër janë siguruar prej tyre në përputhje me Aktet Ligjore për të Drejtat e Autorit, Kompozimin dhe Patentat 1988.

ISBN 1 84312 336 3

Materialet e këtij publikimi mund të fotokopjohen vetëm për përdorim brenda institucionit ku blihen. Përndryshe, të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem të përdorueshëm apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, elektronike, mekanike, duke u fotokopjuar apo të tjera, pa marrë më parë lejen e printuesit.

Përkthimi në gjuhën shqipe nga Enkeleina Qafleshi dhe publikimi me mbështetjen financiare të organizatës Save the Children, Programi për Shqipërinë, mundësohet me lejen e botuesit të saj.





PËRMBAJTJA



Falënderimet		vi
Hyrja		vii
Kapitulli i parë	Rëndësia e lojës	1
Kapitulli i dytë	Raste studimore	15
Kapitulli i tretë	Aftësitë për të luajtur	41
Kapitulli i katërt	Këshilla kryesore për krijimin e një ambienti loje sfidues	53
Shtojca 1	Paketa e regjistrimit	61
Shtojca 2	Rrethi i miqve dhe familjes – bosh	69
Shtojca 3	Aktiviteti i Shkallëve Paralele të Arushave - bosh	71
Referencat		73
Lexime të tjera		74
Adresa të nevojshme		75



FALËNDERIMET

Ne dëshirojmë të falënderojmë Xhonin, Viktorian dhe Sarën për inkurajimin që na dhanë.


Dëshirojmë të falënderojmë gjithashtu kolegët e Parashkollës Medway për mirëpritjen e tyre dhe për përkushtimin dhe pasionin e thellë që shfaqën për edukimin në fëmijërinë e hershme.

Dëshirojmë të falënderojmë punonjësit e David Fulton Publishers dhe veçanërisht Linda Evans.

Falënderime edhe për Xhejsi Abram për ilustrimet.

HYRJA

Loja është mënyra kryesore e të nxënit në fëmijërinë e hershme. Fëmijët e vegjël nxënë më mirë nëpërmjet përvojave personale dhe metodave multisensoriale të mësimdhënies që nxisin ndjesorët e tyre natyralë të kuriozitetit. Loja, në të gjitha format e saj, paraqet mundësi të pafundme për ndërveprimin e fëmijëve me njerëzit dhe objektet, në situata reale dhe imagjinare, dhe duhet të jetë qendrore në planifikimin e kurrikulës së Fazës Bazë.



Një specialist i mirë është i hapur për të kapur interesin e fëmijëve dhe për ta bërë kurrikulën që t'i përshtatet fëmijës dhe jo anasjelltas. Informacioni në faqen 25 të *Udhëzuesit për Kurrikulën e Fazës Bazë* (QCA 2000) prezanton disa parime kyç. Fëmijët mundën:

- të eksplorojnë, zhvillojnë dhe pasqyrojnë përvoja mësimore të cilat i ndihmojnë në deshifrimin e botës që i rrethon.
- të praktikojnë dhe ndërtojnë ide, koncepte dhe aftësi
- të mësojnë se si të kontrollojnë impulset dhe të kuptojnë nevojën për rregulla
- të qëndrojnë vetëm, të qëndrojnë me të tjerë ose të kooperojnë ndërsa flasin apo praktikojnë ndjenjat e tyre

- të rrezikojnë dhe të bëjnë gabime
- të mendojnë në mënyrë kreative dhe me imagjinatë
- të komunikojnë me të tjerët ndërsa hulumtojnë ose zgjidhin probleme
- të shprehin frikë ose të përjetojnë përvoja të ankthshme në situata të kontrolluara dhe të sigurta

Në botën e sotme theksi kryesor vihet tek vlerësimi, regjistrimi, monitorimi dhe testimi. Specialistët harxhojnë sasi të mëdha kohe duke shënuar kuti pyetësorësh dhe duke mbushur formularë vëzhgimesh (të cilat, meqë ra fjala, në shumicën e rasteve janë thjesht përshkrime të asaj që fëmijët po bëjnë më tepër sesa vëzhgime të fokusuara që japin informacion). Fëmijët meritojnë dedikimin entuziast dhe ndërveprues të një specialisti i cili i ndihmon ata të ndërtojnë më shumë mbi atë që dinë dhe i mëson e i frymëzon që të dëshirojnë të dinë më shumë.

Ky libër fillon me një kapitull të shkurtër (Kapitulli 1) rreth teorive të lojës, përfshirjes së prindërve dhe mënyrës se si të luajturit mund të ndihmojë fëmijët me vështirësi emocionale. Rastet studimore në Kapitullin e dytë pasqyrojnë disa nga mënyrat se si fëmijët prezantohen dhe ide mbi si mund t'i ndihmojmë ata. Në kuadrin e numrit gjithmonë në rritje të fëmijëve të cilëve u mungojnë aftësitë e lojës në moshën e hershme dhe të cilët u kalohen Skuadrave të Ndërhyrjes së Sjelljes, ne menduam se ky libër mund të jetë me vlerë për specialistët të cilët dëshirojnë të bëjnë diçka praktike (dhe të kënaqshme) në këtë fushë. Libri vazhdon me idetë për të mbështetur të nxënë të fëmijëve (Kapitulli 3) dhe me sugjerimet për të krijuar një mjedis mësimor të përshtatshëm (Kapitulli 4).

Në kohët tona duket se fëmijët e kalojnë pjesën më të madhe të kohës ose brenda shtëpive të tyre, ose brenda shtëpive të shokëve apo brenda dyqaneve. Shfaqet një mungesë e theksuar dëshire nga ana e prindërve për t'u lejuar fëmijëve më shumë liri në ambientet jashtë shtëpisë. Shumica e fëmijëve çohen në shkollë me makinë si dhe merren po me makinë, edhe nëse jetojnë fare pranë. Megjithatë është e kuptueshme në njëfarë mase, kjo mund të sjellë limitizimin e zhvillimit të fëmijës. Nisur nga ky këndvështrim, merr një rëndësi të veçantë fakti që parashkollat dhe shkollat nevojitet të ofrojnë një hapësirë përjashta për të nxënë dhe eksploruar.

Nuk ka asgjë që zëvendëson lojën përjashta. Fëmijët që kanë mundësi të luajnë rregullisht përjashta do të jenë më të shëndetshëm, më të lumtur, do të mësojnë nga ambienti i tyre dhe do të jenë më pak të stresuar. Është e vështirë të kopjosh aktivitetet që bëhen përjashta në ambientet e brendshme dhe është e pamundur që të riprodhohet ndjenja e lirisë dhe e eksplorimit që ofrohet nga mjedisi i jashtëm. Zhvillimi i aftësive motorike të mëdha është një nga hapat më esenciale për të nxënë në të ardhmen dhe kjo mund të praktikohet mirë vetëm përjashta, në pajisje të mëdha.

Një mjedis ideal për fëmijërinë e hershme është një ambient mësimor që ka rrjedhshmëri, cilësi të lartë, është i strukturuar dhe planifikuar me kujdes, i orientuar drejt lojës, brenda dhe jashtë. Fëmijët kanë shumë më tepër gjasa të mësojnë konceptet si ngjyra duke parë bimët dhe kafshët gjatë një ushtrimi ngacmues në ambientet e jashtme mbi 'gjetjen e fakteve'. Fëmija që kundërshton të marrë pjesë në aktivitete me lapës dhe letër mund të jetë me i interesuar në qoftë se i kërkohet të gërmojë për krimbin më të gjatë apo të gjejë kërmillin më të vogël!

KAPITULLI

1

Rëndësia e lojës

Teoritë e lojës

Përfshirja e prindërve

Përdorimi i lojës për të ndihmuar fëmijët
me vështirësi emocionale

Të nxënëet nëpërmjet lojës



Teoritë e lojës

Imagjinoni një skenë tipike të një grupi fëmijësh në kuzhinë. I pari është 18 muajsh dhe mban një tigan. Ai ka mundur të gjejë një lugë druri dhe po “bën një kek”. Një fëmijë tjetër është ulur në tokë me kukullat e saj dhe po u lexon atyre një përrallë. I treti është ulur në tavolinë, ka gjetur dy lugë dhe është duke i përplasur ato sëbashku duke thënë “Unë jam pop star”.

Përgjatë të gjitha kohërave fëmijët e shëndetshëm kanë gjetur mundësi për të luajtur, por këtij aktiviteti nuk i është njohur gjithmonë vlera ashtu siç duhet. Më poshtë do të gjeni disa nga teoritë më të rëndësishme që janë prezantuar përgjatë viteve si përpjekje për të shpjeguar lojën e fëmijëve.

Teoria e Evolucionit

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, teoria e evolucionit dha një informacion të thellë për sa i përket zhvillimit të fëmijës dhe ishte një nxitje për studimet në këtë fushë. Interesi për zhvillimin e të vegjëlve të specieve të tjera solli një interes për foshnjat e sapolindura dhe për mënyrën se si fëmijët mësojnë të bëhen të rritur. Loja u vëzhgua me kujdes dhe nisi të konsiderohej si një praktikë esenciale për t’u bërë i rritur nëpërmjet lojës së roleve. Kjo mund të kuptohet që fëmijët kopjojnë një gamë aktivitetesh dhe sjelljesh të demonstruara nga të rriturit në lojëra të tilla si “të luash mamin dhe babin”, në këndin shtëpiak, dhe “të luash shkollash”.

Praktikimi i aftësive për mbijetesë

Kjo teori e vë theksin në praktikimin e aftësive të mbijetesës. Ajo thekson lojën si një praktikë dhe perfeksionim i aftësive që do të nevojiten më vonë në jetë. Ashtu si në teorinë e mësipërme, kjo ide u krijua nisur nga studimi i kafshëve ku të vegjëlit e kafshëve u vëzhguan vazhdimisht të luanin lojë luftash si përgatitje për vetëmbrojtjen përgjatë jetës së tyre të mëtejshme.

Në zhvillimin e të vegjëlve të njeriut kjo mund të shihet në fusha të tilla si të nxënë të fëmijëve lidhur me ndarjen e gjërave me të tjerët ose me marrjen e radhës dhe në përpjekjet e tyre për të zgjidhur konfliktet. Këto janë të gjitha aftësi që do t’u nevojiten këtyre individëve për të marrë pjesë plotësisht në organizimin social të jetës, si në shkollë, punë dhe familje.

Loja si një mënyrë të sjelli

Loja lidhet zakonisht me të qeshurën dhe zbavitjen dhe konsiderohet si një aktivitet që jep kënaqësi. Fëmijët mund të thithen totalisht nga një aktivitet i cili u intereson me të vërtetë. Kjo teori mbështetet mbi faktin që loja është një gjendje e mendjes dhe buron nga thithja prej një aktiviteti të pëlqyeshëm.

Ne mund ta shohim këtë kur vëzhgojmë fëmijë të cilët duken totalisht të përfshirë në lojën e tyre të roleve. Çdo vëzhgim i kryer në strukturat parashkollore do të përfshijë fëmijë që janë në këndin e maskimit dhe që “bëhen” zjarrëfikës ose shitëse. Në mënyrë të ngjashme, shumë fëmijë përfshihen plotësisht nga lodrat me shkak-pasojë, veçanërisht lodrat muzikore, dhe luajnë me to shumë e shumë herë.





Loja dhe rritja e inteligjencës

Një teori tjetër u ofrua nga Piazhe (Jean Piaget), i cili vëzhgoi me shumë kujdes zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Fillimisht një zoolog, idetë e Piazhesë kanë qenë shumë influencuese në fushën e zhvillimit të fëmijës. Piazhe hipotizoi se loja ishte shumë e lidhur me rritjen e inteligjencës. Ai foli për dy procese që ai besonte të ishin bazat e gjithë zhvillimit: “asimilimi” dhe “akomodimi”, që do të thotë pak a shumë t’i marrësh gjërat përbrenda dhe t’i kuptosh e t’i përdorësh ato.

Piazhe foli për ndërveprimin konstant që nevojitet midis këtyre dy proceseve për një të nxënë efektiv. Fëmija përpiket të kuptojë gjithmonë informacionin që merr dhe përpiket ta lidhë atë me diçka që ai di.

Kur këto dy procese nuk janë në balancë, sipas komenteve të Piazhesë, sjellin si rezultat imitimin. Kjo ndodh sepse fëmija është i hutuar dhe po përpiket të kuptojë situatën në mënyrën më të mirë që ai njih. Fëmijët që luajnë të njëjtën lojë apo të njëjtin rol në mënyrë të përsëritur, bazuar në diçka që kanë parë, mund të jenë thjesht duke imituar.

Asimilimi është mënyra e fëmijës për të kuptuar informacionin. Ai jep si rezultat lojërat gjatë të cilave fëmija luan me informacionin që ato kanë në mënyrë që ta kuptojë atë.

Loja si një mënyrë për të kuptuar emocionet

Psikoanalisti i famshëm Frojd tërhoqi vëmendjen në faktin që fëmijët mësojnë se si të menaxhojnë emocionet e tyre nëpërmjet lojës. Fëmijët mundin të menaxhojnë në një mënyrë të sigurt një gamë emocionesh nëpërmjet lojës së roleve ose duke aktruar një përrallë. Kukullat mund të jenë shumë të dobishme në situatat kur fëmija e ka më të lehtë të shprehë ndjenjat përmes një personazhi tjetër.

Specialistët e sotëm kuptojnë që loja i shërben një game funksionesh në faza të ndryshme të zhvillimit social, emocional, intelektual dhe të mënyrës së të sjellit të fëmijës si dhe jep një kontribut jetësor në përgatitjen e tyre për moshën madhore.



Përfshirja e prindërve

Specialistët e fëmijërisë së hershme kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në ndarjen e njohurive të tyre mbi rëndësinë e lojës me prindërit dhe kujdestarët dhe në ofrimin e sugjerimeve mbi si mund të mbështetet të nxënë në shtëpi. Prindërit duan t’u japin fëmijëve të tyre startin më të mirë në rrugën e jetës dhe mund të jenë të ndjeshëm ndaj reklamave në televizor dhe në revista mbi të ashtuquajturat lodra “edukative”. Ato mund të jenë të shtrenjta dhe shpesh nuk janë asgjë më shumë se mashtrime. Në shumicën e rasteve, eksperiencat më të vlefshme mësohen me kosto të ulët ose edhe pa asnjë kosto në ambientin e shtëpisë. Prindërit habiten kur i blejnë fëmijës një lodër të re dhe shikojnë që fëmija është më i interesuar në kutinë e kartonit që mbështjell lodrën sesa në atë që është brenda. Kutia prezanton një stimulues për imagjinatën e fëmijës: ajo mund të kthehet në një makinë, anije kozmike, varkë, shtëpi etj.





Informimi i prindërve për çfarë ndodh në parashkollë si dhe për temat që mbulohen mund t'u japë atyre ide për aktivitete. Një tabelë informacioni e rregullt mund të ndihmojë – por kujdes të mos i bombardoni familjarët me shumë letra! (Shikoni faqen 5-6 për një shembull gazete).

Ka shumë mënyra për të inkurajuar prindërit që të marrin pjesë në aktivitetet e lojës së fëmijës. Për shembull:


- Grupet e prindërve dhe fëmijëve që sa kanë filluar të ecin ftojnë prindër të tjerë për të luajtur së bashku me fëmijët e tyre. Këto mund të jenë aktivitete arti dhe punëdoreje, lojëra me lodra ndërtuese, bashkëndarje librash ose thjesht biseda me fëmijët mbi atë që po ndodh. Për shembull, bërja e bukës ose loja me plastelinë mund të inkurajojnë përdorimin e një gjuhe të pasur dhe gjithashtu të zhvillojnë të menduarin kreativ dhe imagjinar.
- Disa parashkolla përdorin prindërit si vullnetarë për të ndihmuar në seanca të caktuara. Këto seanca zakonisht janë po aq argëtuese për prindërit sa dhe për fëmijët. Kjo ofron një mundësi për prindërit që të shohin se sa pajisje zbavitëse mund të përdoren në hapësira të vogla. Për shembull, një tabaka e vogël me rërë dhe një tas me ujë, me një rugicë plastike nëntë, mund të përdoren edhe në shtëpi apo në oborr. Pajisje shtëpiake siç janë lugët, gotat plastike si dhe enë të tjera shtëpie mund të ofrojnë një praktikë të pasur për fëmijët ku prindërit mund të shtojnë përdorimin e gjuhës për të mbështetur zhvillimin e fëmijës me koncepte matematikore dhe shkencore siç janë “më e rëndë”, “zhytje”, ose “sa?”.
- Është e rëndësishme që prindërve që e kanë të vështirë të luajnë me fëmijët e tyre t'u tregohen modele të mira. Nevojitet që personeli i parashkollës të lavdërojë fëmijën për aktivitetet që po realizon dhe të demonstrojë se sa efektiv është lavdërimi për të inkurajuar fëmijët që të zhvillojnë lojën dhe të përqendrohen në aktivitet. Për disa prindër, të shohin se si fëmija reagon ndaj kësaj sjelljeje mund të jetë një ndihmë për t'i parë fëmijët e tyre me sy tjetër.
- Gjithnjë e më shumë në qendrat për fëmijët janë duke u krijuar biblioteka lodrash. Nëse një fëmijë në parashkollë ose nën kujdestari tregon interes për një lodër të veçantë, është e mundur që kjo lodër ose një e ngjashme të merret borxh nga biblioteka e lodrave.
- Ka shumë skema që janë krijuar për të inkurajuar prindërit dhe fëmijët që të luajnë së bashku. Në disa raste një profesionist shkon në shtëpinë e familjes dhe luan me fëmijën (me lodrat e vetë fëmijës ose me lodra që ai i sjell me vete) për të demonstruar aktivitetet e përshtatshme. Disa skema të tjera inkurajojnë prindërit që të takohen në vende që janë të përshtatshme për të gjithë familjen, në të cilat organizohet një gamë e gjerë aktivitete. (Hollësi të mëtejshme për këto skema mund të gjeni në qendrat lokale të informacionit mbi fëmijët.) Këto skema janë shumë të vlefshme për t'u demonstruar prindërve lojëra të ndryshme dhe për t'u zgjeruar atyre 'repertorin' e gjërave që mund të realizojnë me fëmijët. (Shikoni faqen 5-6 për disa sugjerime të lojërave që mund të luhen me fëmijët)
- Në shumë parashkolla loja përjashta po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme sepse profesionistët kanë kuptuar që fëmijët përfshihen dhe nxënë më shumë në ambiente natyrore. Prindërit inkurajohen shpesh që të shikojnë ose të bashkohen me disa nga aktivitetet përjashta dhe më pas t'i përsërisin këto aktivitete në shtëpi. Një shëtitje në dyqanet e zonës mund të çojë në përgatitjen e listës së pazarit, marrjen e vendimit mbi ç'rugë do të merret për të vajtur atje, bërjen e



“Rritja dhe gjërat e gjalla”

Tashmë që pranvera ka lulëzuar, ne do të fokusohemi veçanërisht me fëmijët tek ‘ritja dhe gjërat e gjalla’. Kemi planifikuar disa aktivitete shumë interesante që përfshijnë:

- Vëzhgimin e ciklit të jetës së një fluturë dhe një bretkose (larvat dhe vezët duhet të na vijnë nga java tjetër – mbani sytë hapur për gjërat e gjalla që janë përreth!).
- Një vizitë në një nga fermat e zonës (prindërit dhe kujdestarët do të ftohen të marrin pjesë – hollësitë do t’i merrni më vonë.)
- Një kërkim për “kafshë të vogla” në oborrin përjashta
- Rritjen e një game të gjerë zarzavatesh dhe lulesh, vëzhgimin dhe matjen e rritjes së tyre
- Një vizitë nga një vizitor shëndetësor i cili do t’u shpjegojë se si të mbrojnë shëndetin e tyre



Ka shumë mënyra me të cilat ju mund të ndihmoni zhvillimin e të nxëniet të fëmijës suaj për sa i përket “ritjes dhe gjërave të gjalla” në shtëpi. Këto janë disa sugjerime nga ne – do t’ju luteshim që të na njoftoni për idetë tuaja të mira që ne të mund t’i ndajmë me prindërit e tjerë!

- Një vizitë në park për të parë gjethet, sythat, lulet, insektet dhe për të folur për to.
- Të bëni një katalog me gjërat e gjetura në park
- Një vizitë në një kopsht botanik të zonës për të parë bimët, filizat, pemët dhe shkurret.
- Gërmimi dhe mbjellja – ka shumë bimë që rriten mjaft mirë në vazo, pranë një dritareje, nëse aksesit në një oborr apo ‘ngastër’ është i vështirë. (Majat e prera të karrotave në një tavë me ujë lëshojnë sytha shumë shpejt dhe kërkojnë shumë pak kujdes)
- Flisni për kafshët shtëpiake – se si ato kanë ndryshuar duke u rritur dhe për ç’lloj kujdesi kanë nevojë
- Flisni për rritjen e vetë fëmijëve si dhe për ushqimin/kujdesin që atyre u nevojitet për të qenë të shëndetshëm
- Shikoni së bashku fotografi të fëmijëve (që kur kanë qenë bebe deri në të tashmen)

Faleminderit për bashkëpunimin – kënaquni në hulumtimin me fëmijën tuaj!

Personeli i çerdhës

[Burimi: nga Drake (2005) *Panifikimi i Lojës dhe të Nxëniet të Fëmijëve në Fazën Bazë*]

Lojëra për t'u luajtur

Pikniku i arushëve prej lodre (ose përdorni kukulla, marioneta, kafshë prej pellushi). Flisni mbi çfarë duhet të merrni me vete – sanduiçe, biskota, kek, diçka për të pirë. Përgatisni piknikun (real ose prej gjasme). Shtroni një mbulesë – brenda ose jashtë, në oborr apo në park. Ndani ushqimin, “A dëshiron një sanduiç arush?” – duke thënë të lutem dhe faleminderit. Bisedoni për ushqimet që ju pëlqejnë dhe ato që nuk ju pëlqejnë. Sigurohuni që të hiqni të gjitha mbeturinat. Bëni sëbashku larjen e enëve.

Bëni një kamp (ose shtëpi, shpellë, anije kozmike) brenda ose jashtë. Siguroni një batanije të vjetër apo një perde, një copë të madhe kartoni ose një kuti. Një varëse për tharje rrobash mund të krijojë mbajtësen, ose një shilarës apo shkallët paralele: brenda vendosni një tavolinë ose dy karrige. Siguroni një ndriçues, nëse është shumë errësirë brenda. Bëni një krevat dhe disa ndenjese me jastëkë dhe një batanije. Ftoni vizitorë – mirëpritini ata.

Zini brumë. Përzjeni mirë përbërësit (1 gotë miell, 4 lugë çaji kripë, 7-8 gota ujë të ftohtë si dhe pak ngjyruar ushqimor) dhe futini në frigorifer. Jepini forma të ndryshme ushqimesh, kafshësh etj. Shikoni kush mundet të bëjë ‘krimbin’ më të gjatë.

Bëni një kek duke përdorur formulën ‘të gjitha bashkë’. (115mg margarinë, 115mg sheqer pluhur, 2 vezë, 115mg miell me maja, 60mg rrush të thatë ose copa çokollate). Hidhni të gjitha harxhet në një tas dhe përziejini mirë me një lugë druri deri sa të mos ketë më copa të mëdha. Kalojeni brumin nëpër enë prej letre mbi një tavë furre dhe piqueni në nivelin 4 ose në temperaturën 180°C për 15-20 minuta. Pastroni enët sëbashku. (Bëni kujdes kur jeni afër sobës apo furrës – bisedoni mbi nxehtësinë dhe pse është e rëndësishme të bëhet kujdes etj. – vetëm të rriturit mund ta përdorin furrën.)



Dyqanet, posta, kafeneja. Mblidhni disa ‘materiale skene’. Bëjeni me radhë se kush do të bëhet blerësi dhe kush shitësi apo kamarjeri. Përdorni para të vërteta apo të rreme.

Kukafshehthi. Një nga pjesëmarrësit mbyll sytë dhe numëron deri në dhjetë – ose reciton ndonjë vjershë të njohur ose pret derisa të mbarojë një këngë, pastaj fillon të kërkojë të tjerët të cilët tashmë janë fshehur. I pari që do të gjehet do të jetë ai që do të mbyllë sytë herës tjetër. Luani në oborr, në shtëpi ose në park (nëse ky është i sigurt).

Birilat. Bëjini vetë duke përdorur shishe plastike. Përdorni një top të madh – rrokulliseni, hidhni ose gjuajeni atë me këmbë.

Futbolli. Caktoni një zonë për portën dhe gjuajeni topin me radhë për të bërë gol. Bëni një rreth me një spango, hidhni aty me radhë qese me fasule, guaska, gurë. Shikoni se kush do të fusë më shumë brenda rrethit.

Si bëjnë kafshët. Thërrisni me radhë emrin e një kafshe – të gjithë duhet të bëjnë lëvizjet dhe zërin e asaj kafshe.

Statujat. Kërceni/ecni/hidhuni nën tingujt e një muzike ose zhurmës së daulles. Kur të pushojë muzika, të gjithë duhet të ‘ngrijnë’ derisa të fillojë muzika përsëri.

parave dhe çantës së pazarit gati. Arushi apo kukulla mund të merren me vete në karrocën e vogël. Ushtrimi fizik që realizohet gjatë lojërave përjashta dhe shëtitjeve është një pjesë e jetës së shëndetshme dhe duhet inkurajuar.

- Edhe një oborr fare i vogël ose një vend përjashta mund të përdoren për të rritur lule, mbase nëpër vazo. Mjediset e fëmijërisë së hershme mund ta inkurajojnë këtë tip aktiviteti duke u demonstruar fëmijëve se si të mbjellin fara lulesh dhe si të kujdesen për to – ndoshta edhe duke organizuar një konkurs për të parë lulet e cilit fëmijë do të rriten më shumë etj.



Përdorimi i lojës për të ndihmuar fëmijët me vështirësi emocionale

Shumica e punonjësve të parashkollës do të përjetojnë, shpejt apo vonë, situata të tilla ku një fëmijë ka pësuar një humbje të madhe, apo ka dikë që është shumë sëmurë apo ka ndonjë lloj tensioni në familje. Në raste të caktuara, mund të ekzistojnë shqetësime edhe për sigurinë e fëmijës brenda situatës familjare. Shumë njerëz nuk janë të sigurt se cila është mënyra më e mirë për ta ndihmuar fëmijën dhe për të ndihmuar gjithashtu fëmijët e tjerë në parashkollë që të reagojnë në mënyrë dashamirëse. Qëllimi i kësaj pjese të Kapitullit 1 është që të ndihmojë në njohjen e emocioneve që këta fëmijë mund të jenë duke përjetuar dhe të ofrojë disa këshilla praktike nëpërmjet aktiviteteve të lojës.

Është e rëndësishme të vihet re se disa fëmijë mund të kenë nevojë për mbështetje shumë të specializuar për të përballuar vështirësitë e tyre emocionale dhe mund të krijohet mundësia për t'u lidhur me specialistët e përfshirë, mundësisht një psikolog ose këshillues edukimi, në mënyrë që të bisedohet me ta mbi rrugën më të përshtatshme për të ndjekur. Nëse ka shqetësime për sa i përket sigurisë, atëherë duhet të hyjnë në fuqi procedurat e mbrojtjes së fëmijës. Megjithatë, me mbështetjen e të rriturve, shumë fëmijë mund të orientohen drejt mënyrave të menaxhimit të shqetësimeve të tyre.

Një nga aspektet më të rëndësishme të shtëpisë, kujdestarëve apo ambienteve parashkollore është që fëmija ka ndërtuar tashmë raporte me të rriturit dhe ndodhet në një mjedis familjar. Fëmijët ndihen më të qetë dhe i ndajnë më lehtë shqetësimet e tyre kur ndodhen në një mjedis familjar me të rritur që kanë fituar besimin e tyre.

Identifikimi

Fëmijët i tregojnë shenjat e shqetësimit në mënyra të ndryshme:

- Ankth i vazhdueshëm
- Ndryshime të papritura të gjendjes emocionale
- Mungesë përqendrimi
- Të qara të papritura, pa ndonjë arsye të dukshme
- Çrregullime/vështirësi në të ngrënë
- Demonstrim sjelljesh seksuale

- Mungesë në të shprehur
- Mungesë dëshire për t'u kthyer në shtëpi
- Mungesë totale dëshire për të luajtur me fëmijët e tjerë

Çdonjëra nga këto sjellje mund të jetë një sinjal për ndjenjat e inatit, zemërimit, hidhërimit, tradhëtisë, hutimit ose fajësimit të vetes. Fëmijët shpesh ia vënë fajin vetes nëse gjërat shkojnë keq në shtëpi. Mund të bëhet p.sh. një koment i tipit “Fëmijët po më çmendin, nuk duroj dot më”. Një fëmijë i ndjeshëm mund ta marrë këtë koment shumë seriozisht dhe t’ia vërë fajin vetes, veçanërisht nëse kjo përfundon në një grindje midis prindërve. Një fëmijë mund të përballet me një skenë dramatike, p.sh. Mami ose Babi që shajnë, përplasnin dyert dhe thonë se do të ikin. Fëmijëve u futet ankthi nëse prindi nuk kthehet. Siguria mund të bëhet një shqetësim i vërtetë për këta fëmijë.

Nëse vini re ndonjë nga simptomat e mësipërme, do të ishte me vend të përqendroheshit në lojën e fëmijës për të parë nëse ka mundësi për ta mbështetur këtë fëmijë. Një vëzhgim i kujdesshëm mund të ofrojë informacion të dobishëm për çdo specialist të cilit më vonë mund t’i duhet të përfshihet. Atje ku ka shqetësime – mund të jetë e dobishme që të flisni me prindërit apo kujdestarët – por, në këto raste, duhet përdorur shumë takt dhe një konfidencialitet i lartë.

Çfarë mund të ndihmojë?

Tregimet

Ka shumë tregime tashmë që mbulojnë çështje të tilla si humbjet e mëdha, ndarjet ose një vëlla apo motër që është i ndryshëm. Këto tregime ndoshta është më mirë të lexohen në situata grupi në mënyrë që fëmijët të kenë mundësi të bëjnë komente të ndryshme. Fillimisht, një fëmijë që po kalon vështirësi emocionale mund ta ketë të vështirë të shprehë një mendim apo të bëjë komente. Këta fëmijë gjithashtu mund të ndihen të pasigurt për ndjenjat e tyre. Shumë fëmijë shpesh nuk zotërojnë fjalorin e nevojshëm për të shprehur se si ndihen dhe tregimet mund të jenë një mundësi e mirë për ta ndihmuar fëmijën të gjejë fjalët e duhura për emocionin e tij. Fëmija mund të ndihmohet duke dëgjuar komentet dhe pikëpamjet e fëmijëve të tjerë. Kjo bëhet edhe më efektive nëse fëmijët përfshihen në tregim duke u bërë atyre pyetje të tilla si “Si mendoni që djali i tregimit ndihej në atë moment?” dhe mundësisht “A është ndjerë ndonjëherë ndonjëri nga ju si ky djali i tregimit?”.

Fëmija mund të japë një përgjigje por, nëse nuk ndihet gati për t’u bashkuar në diskutim, mund të jetë e dobishme për të që thjesht të dëgjojë këndvështrimet e fëmijëve të tjerë. Është gjithashtu një ndihmesë nëse të rriturit flasin rreth faktit që këto ndjenja janë normale.

Disa nga librat e dobishëm për të folur rreth humbjeve të mëdha janë:

- *Gjyshi im dhe unë*, nga Aleks Marlei (ISBN 085648 442 3)
- *Lamtumirë Maks*, nga Holli Keller (ISBN 0862 03307 1)
- *Macja e Emës vdiq*, nga Nigel Snell (ISBN 0241 11297 4)
- *Dhurata e Baxherit për largimin*, nga Suzan Varlei (ISBN 0862 64062 8)

Këshilla dhe burime lidhur me humbjet e mëdha mund të gjehen pranë degës lokale të Përkujdesjes ndaj Humbjeve të Mëdha (shiko kapitullin ‘Adresa të nevojshme’ për informacionet e kontaktit).

Shtëpia e Kukullës

Një shtëpi kukulle me një gamë personazhesh mund të ndihmojë fëmijët të aktrojnë situata të ndryshme. Shumë nga fëmijët do të luajnë të njëjtën situatë në mënyrë të përsëritur, derisa të arrijnë ta kuptojnë atë një çikë më mirë. Disa fëmijë mund të ndihmohen duke pasur një të rritur me ta i cili t'u flasë dhe t'u shpjegojë veprimet e kukullave dhe të bëjë pyetje mbi çfarë po bëjnë personazhet dhe përse. Ky është një shans i mirë për të shpjeguar se, kur Mami mund ta ketë ngritur zërin, kjo ka ndodhur sepse ishte shumë e lodhur. Një ushtrim i tillë do ta ndihmonte fëmijën që ndihet si shkak i mërzisë së prindërve.

Marionetat

Duke aktruar një situatë nëpërmjet marionetave dhe kukullave fëmija ka mundësi që të transmetojë ndjenjat e tij apo të saj në një mënyrë të sigurt. Marionetat mund të ndihmojnë shumë një fëmijë që është shumë i qetë apo që nuk flet me të tjerët. Fëmijët kanë mundësinë të projektojnë zërat e tyre si dhe personalitetin e ndonjë personi që njohin tek marionetat ose kukullat. Edhe nëse fëmija nuk arrin të vokalizojë ai është në gjendje të përdorë kukullat për të ndërmarrë veprime dhe studimi i këtyre veprimeve mund të japë shpesh indikatorë për ndjenjat e fëmijës. Është gjithashtu e dobishme të vëzhgohet se si marioneta lidhet dhe komunikon me marionetat apo kukullat e tjera.

Këndi i karnavaleve

Të veshurit me kostume i lejon fëmijët që të marrin role të ndryshme dhe të përballojnë ankthin dhe emocionet e tyre. Për shembull, një fëmijë në rolin e Babait mund të ngrejë zërin dhe të shajë shumë, duke imituar atë lloj sjelljeje prindërore që ai sheh në shtëpi. Vëzhgimi i këtij skenari mund t'u japë specialistëve të fëmijërisë së hershme një informacion të dobishëm për sa i përket situatës familjare të këtij fëmije – por kini kujdes të mos nxirri konkluzione të nxituara; fëmija mund të jetë duke imituar një skenë nga një telenovelë në televizion dhe jo duke reflektuar situatën e tij familjare! Biseda të kujdesshme me fëmijën do të përcaktojnë se ku e ka parë ai sjelljen që po imiton.

Fëmijët shpesh fajësojnë veten për gjërat që nuk shkojnë dhe zona e karnavaleve mund të ofrojë një shans të mirë për të vënë në skenë situatat në një mënyrë të sigurt apo për të provuar mënyra alternative për t'u përgjigjur situatave.

Drama

Fëmijët mund të dëgjojnë tregime dhe pastaj t'i luajnë ato si teatër. Shumë tregime për fëmijë mund të realizohen në këtë mënyrë, ku fëmijët mund të marrin çdo herë role të ndryshme. Shumicës së fëmijëve u pëlqen që tregimet të përsëriten. Për shembull, tregimi i *Tre Derrkucave të Vegjël* mund të vihet në skenë shumë lehtë me fëmijë të ndryshëm në rolet e ujkut dhe tre derrkucave. Kostume të thjeshta mund të krijohen nga vetë fëmijët. Ato mund të përgatiten me sende të tilla si rreth koke me veshë rozë për derrkucat dhe një maskë ujku. Ka shumë fabula dhe tregime që trajtojnë çështje të caktuara të cilat mund të përdoren. Shërbimi i bibliotekës zakonisht mund të ndihmojë me një listë të librave të përshtatshëm.

Një mënyrë tjetër është që fëmijëve t'u kërkohet që të imitojnë emocionet si pjesë e tregimit, për shembull, "Pastaj fshatari u zemërua. Pa të shohim nëse ju mund ta bëni fytyrën të zemëruar si fshatari." Ky lloj aktiviteti i ndihmon fëmijët të identifikojnë dhe t'u vënë një emër ndjenjave të tyre dhe të njerëzve të tjerë. Gjithashtu, fakti që të gjithë njerëzit kanë ndjenja të ngjashme mund t'u japë atyre siguri.



Fëmijët gjithashtu mund të inkurajohen që të krijojnë tregimet e tyre dhe të zgjedhin personazhet e tyre. Ky ushtrim mund të drejtohet nga të rriturit ose mund të bëhet në mënyrë të pavarur nga fëmijët. Shumë fëmijë kanë dëshirë që të përfshihen në aktivitete imagjinare si pjesë normale e të nxënës dhe zhvillimit të tyre.

Arti

Për shumë fëmijë, vizatimi dhe piktura janë një eksperiencë shumë stimuluese. Fëmijët shpesh zgjedhin ngjyra të cilat përfaqësojnë gjendjen e tyre emocionale si të kuqen për inatin dhe të zezën kur ndihen të dëshpëruar. Është me shumë vlerë t'u japësh fëmijëve mundësinë që të përdorin ngjyra ose materiale punëdoreje në mënyrë të tillë që të shprehin emocionet e tyre. Disa fëmijë mund të bëjnë një vizatim dhe më pas ta mbulojnë të gjithë vizatimin me të zezë ose të kuqe, me vija të trasha.

Mund të jetë e dobishme t'u kërkoni fëmijëve të vizatojnë gjëra specifike me raste, si familjen e tyre ose kafshët që kanë në shtëpi ose veten e tyre. Nëse një fëmijë është i aftë të përdorë vizatimin ose pikturën si një mjet transmetimi, kjo mund të jetë shumë efektive për t'i dhënë atij mundësi që t'i vendosë ndjenjat në një format konkret dhe i hap atij rrugën për të folur rreth tyre.

Arti përdoret nga specialistët si teknikë terapeutike dhe më shumë informacion për këtë mund të gjehet tek Shoqata Angleze e Terapisë Artistike (shiko kapitullin 'Adresa të nevojshme' për të dhënat e kontaktit.)



Lojërat

Disa fëmijë e kanë shumë të vështirë t'i ndajnë pajisjet me të tjerët apo të presin radhën. Lojërat përbëjnë një mënyrë shumë të strukturuar për të ndihmuar zhvillimin e këtyre aftësive. Lojëra të tilla si llotaria e figurave, dominotë dhe lojërat me letra janë të lehta për t'u kuptuar dhe shumica e fëmijëve i kanë shumë qejf. Një pjesë e rëndësishme e këtij lloji aktiviteteve është fakti që nëpërmjet tyre fëmijët mësojnë të pranojnë vendin e dytë ose të tretë dhe të përballojnë të mosqenët fitues të një loje. Lavdërime të përshtatshme nga ana e të rriturve të përfshirë do të mjaftojnë për të përforcuar sjelljen e duhur: “Shumë mirë Mara, më pëlqeu shumë se si e prite radhën sot. Edhe Semit i lumtë sot se ka luajtur shumë këndshëm. Më pëlqeu se si e prite Marën kur ajo po mendohej se cilën letër të luante.”

Lojëra specifike të projektuara si mjete terapie mund të gjenden nga burime të specializuara si Smallwood Publishing Ltd (shiko kapitullin ‘Adresa të nevojshme’ për të dhënat e kontaktit.)

Pajisje të mëdha

Disa fëmijë me vështirësi emocionale dhe të sjelljes kanë shumë përfitim nga mundësia për të vrapuar përreth dhe për të shkarkuar energji në hapësira të bollshme me pajisje të mëdha për të luajtur. Këto hapësira është e nevojshme që të mendohen me kujdes që fëmijët të kenë mundësi të përdorin energjinë e tyre në mënyrë të sigurt. Për disa fëmijë, pajisjet e lojës mund të ofrojnë mundësinë kryesore për zhvillimin e aftësive të mëdha motorike dhe për rritjen e besimit në aftësitë e tyre. Gjithashtu u ofrojnë atyre mundësinë për të qenë në “karrigen e shoferit” për sa i përket kontrollit të triçiklit ose të makinës me pedalë dhe mund të jenë eksperiencia të vlefshme për të ndërtuar vetëvlerësimin.

Hapësirat e vogla të mbyllura

Fëmijët shpesh përfitojnë nga mundësia për t'u tërhequr kur një situatë bëhet e vështirë për ta. Një tendë e vogël në një qoshe të dhomës mund ta ndihmojë fëmijën që të ndihet në një hapësirë të mbyllur e të sigurt. Është e rëndësishme të monitorohet se si përdoren këto hapësira, për sa kohë dhe nga cilët fëmijë. Një përdorim i shpeshtë mund të sinjalizojë një fëmijë i cili ka nevojë për më tepër vëmendje dhe mbështetje.

Përdorimi i veglave muzikore

Veglat muzikore mund t'i ndihmojnë fëmijët të shprehin emocionet e tyre, veçanërisht kur ata kanë një zotërim të limituar të gjuhës shprehëse. Instrumente si daullja, trekëndëshat, këmbanat e dorës dhe ksilofonët janë shumë popullore, por instrumentet e bërë vetë me mjete rrethore mund të jenë po aq zbatimëse – fasule/oriz/guriçka në një kanoçe apo kavanoz; lugë druri dhe një kovë plastike ose tenxhere metalike. Ata mund të luajnë muzikë të gëzuar, të dëshpëruar apo të nevrikosur me instrumentet e tyre, duke e përshtatur edhe me shprehjen e duhur të fytyrës dhe ndoshta duke u inkurajuar nga të rriturit që të flasin rreth gjërave që i bëjnë ata të lumtur, të mërzitur apo të inatosur – ose të tregojnë me gisht figurat përkatëse.

Veglat muzikore mund të luhen gjithashtu nga fëmijët ose të rriturit dhe fëmijë të tjerë mund të inkurajohen që të lëvizin ose kërcëjnë duke ndjekur ritmin. “Hajde të lëvizim në mënyrë të gëzuar. Si ndihemi ne kur jemi të gëzuar?” “Hajde të lëvizim në mënyrë të inatosur”. Ky lloj aktiviteti do t'i ndihmojë fëmijët të njohin ndjenjat e tyre dhe t'i shprehin ato me fjalë.



Shumë specialistë të nevojave emocionale të fëmijës siç janë psikologët e fëmijëve përdorin tipe të ndryshme lojërash terapeutike si një mjet për t'u lejuar fëmijëve të menaxhojnë emocionet e tyre.

Terapia e lojës mund të jetë një ndërhyrje afatshkurtër ose një proces që mund të zgjasë për një kohë të gjatë, në bazë të nevojave specifike të fëmijës. Një terapist i lojës i ndihmon fëmijët të kuptojnë eksperiencat e jetës dhe të shprehin ndjenjat e vështira nëpërmjet metaforave të lojës. Nëse fëmijët janë nën një ndërhyrje të specializuar terapeutike, përpikuni të lidheni me specialistët e përfshirë dhe shikoni nëse ata mund t'ju ofrojnë sugjerime që mund të ndiqen në ambientet e parashkollës.

Të nxënë të nëpërmjet lojës

Shumica e fëmijëve të vegjël mësojnë lehtë, nëpërmjet çdo gjëje që shikojnë dhe dëgjojnë, prekin, shijojnë dhe nuhasin – por më shumë nëpërmjet asaj që “bëjnë”. Megjithatë, për disa fëmijë të nxënë mund të jetë problematik, për shumë arsye. Duke qenë të ndërgjegjshëm për të nxënë që mund të përfitohet nga situata të ndryshme, specialistët e fëmijërisë së hershme mund të ndërmarrin metoda më pro-aktive për të mbështetur të nxënë të fëmijës dhe për të minimizuar të gjitha pengesat e zhvillimit të aftësive bazë.

Listat e aftësive që mund të mësohen nga aktivitetet e ndryshme treguar në faqet 12-14 nuk janë gjithëpërfshirëse, por mund të përforcohen nga specialistët dhe të përdoren në planifikim, veçanërisht për fëmijët që kanë nevojë për mbështetje ekstra.

Lodrat me qëndrim ulur ose me të ngarë

- Bashkëndarja dhe marrja e radhës
- Kontrolli i aftësive motorike
- Eksplorimi i lëvizjeve në hapësirë
- Manovrimi (drejtimi i timonit, kthesat)
- Shmangia e përplasjes – për të kuptuar praninë e të tjerëve
- Përjetimi i shpejtësisë
- Marrja e vendimeve, p.sh. cila rrugë do të merret, me ç'shpejtësi
- Të kuptuarit e shkakut dhe pasojës

Loja me rërë dhe ujë

- Zhvillimi i ideve rreth volumit dhe sasisë, p.sh. më pak dhe më shumë
- Ndryshimi midis rërës së lagur dhe asaj të thatë
- Germim, lojë dhe ndërtim në bashkëpunim
- Pluskimi dhe fundosja
- Zhvillimi i aftësive motorike të mëdha dhe të vogla
- Bashkëndarja e pajisjeve



Lojërat me top

- Nxënia e rregullave dhe pranimi i tyre
- Loja e ndershme
- Marrja e radhës
- Ndjekja e udhëzimeve dhe sinjaleve
- Koordinimi i dorës dhe syve
- Kapja
- Hedhja
- Shkelmimi
- Marrja e nishanit
- Vrapimi
- Rrokullisja

Teatri /dyqani /kafeneja

- Luajtja e roleve, p.sh. imitimi, përdorimi i imagjinatës
- Zhvillimi i gjuhës, p.sh. emërtimi i sendeve, përdorimi i rregullave të duhura të mirësjelljes – të lutem dhe faleminderit etj.
- Njohja e nevojave të tjerëve
- Ndjekja e praktikave sociale dhe pjesëmarrja në to
- Dallimi i veshjes së duhur

Hapësira e oborrit të jashtëm/brendshëm

- Vëzhgimi
- Ndërgjegjësimi për ciklet e natyrës
- Gjërat e gjalla, p.sh. kushtet e nevojshme për rritjen e tyre, ndryshimet
- Matja
- Punëdore artistike
- Zhvillimi i gjuhës, p.sh. fjalori, të qenët i aftë për të komentuar dhe përshkruar
- Vlerësimi i bukurive natyrore dhe respekti për gjërat e gjalla

Pajisjet e mëdha si shkallët paralele

- Ndërgjegjësimi për pjesët e trupit
- Kalimi i peshës në pjesë të ndryshme të trupit
- Koordinimi
- Bashkëveprimi
- Të nxënë e rregullave të sigurisë dhe pranimi i tyre
- Vetëkontrolli
- Vënia në provë dhe zhvillimi i kurajos
- Qëndrimi në ekuilibër, lëkundja, rëshqitja dhe qëndrimi varur

Grafiku ditor i motit

- Vëzhgimi dhe komentimi i kushteve atmosferike
- Vërejtja e efekteve që ka moti mbi lojën, shëtitjet dhe rrobat që duhen veshur



- 
- Eksperienca e përdorimit të instrumentave të thjeshtë për njehsimin e motit
 - Të kuptuarit e ciklit të stinëve
 - Zhvillimi i sensit të mbrojtjes nga moti, p.sh. kremi i plazhit në verë, rrobat e ngrohta në motin e ftohtë etj.



KAPITULLI

2

Raste studimore

1. Një fëmijë që hidhet nga një lodër në tjetrën
2. Një fëmijë që është agresiv ndaj të tjerëve ndërsa luan/u ndërhyn të tjerëve
3. Një fëmijë që nuk do të ndajë gjërat me të tjerët
4. Një fëmijë që i përdor pajisjet në mënyrë të papërshtatshme, vë sendet në radhë, nuk ka kujdes për asgjë
5. Një fëmijë që nuk luan me imagjinatë
6. Një fëmijë që nuk përfshihet në lojën e roleve
7. Një fëmijë që ka frikë të përfshihet në aktivitete me ngjitje/fizike
8. Një fëmijë që nuk tregon frikë ose është impulsiv
9. Një fëmijë që i shmanget lodrave të tilla si biçikletat dhe motorët
10. Një fëmijë që kundërshton të luajë në lojëra të organizuara apo udhëhequra nga të rriturit
11. Një fëmijë që luan gjithmonë rolin e mamasë në këndin e shtëpisë
12. Një fëmijë që nuk dëshiron t'i lërë të tjerët të luajnë të njëjtën lojë me të
13. Një fëmijë që nuk arrin të pranojë humbjen e një loje (mos u nxeh)
14. Një fëmijë që nuk arrin të luajë sipas rregullave të caktuara
15. Një fëmijë që nuk ka dëshirë të luajë përjashta
16. Një fëmijë që luan vetëm me një fëmijë të caktuar
17. Një fëmijë lojë e të cilit është e përsëritur
18. Një fëmijë që përfshihet në lojë vetëm nëse drejtohet nga një i rritur
19. Një fëmijë që gjithmonë kërkon (mban përdore) një të rritur gjatë lojërave përjashta
20. Një fëmijë që mërzitet kur vihet përpara situatash të panjohura
21. Një fëmijë që luan gjithmonë me lodra foshnjash
22. Një fëmijë që del nga kontrolli ose eksitohet jashtë mase gjatë aktiviteteve të furishme
23. Një fëmijë që nuk arrin të presë radhën e vet
24. Një fëmijë që nuk arrin të përshtatet me sugjerimet e të tjerëve gjatë lojës apo aktiviteteve
25. Një fëmijë që përdor shumë dhunë në lojë

RASTI STUDIMOR 1

Një fëmijë që hidhet nga një lodër në tjetrën

Kloi i pëlqen shumë të shkojë në çerdhe. Ajo vrapon direkt brenda dhe shpejt shkon në këndin e shtëpisë, pastaj vrapon të shikojë makinat dhe garazhin. Merr një nga makinat dhe vrapon me të tek rrëshqitëset. Përplas me zhurmë makinën kundrejt rrëshqitëses dhe pastaj lëviz për tek rëra. E vë makinën në rërë dhe pastaj kthehet tek ndihmësja e çerdhes dhe i tregon me gisht oborrin, duke nënkuptuar që ajo dëshiron të dalë të luajë në oborr.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Kloi:

- nuk ka marrë mësim mbi si të zgjedhë aktivitetet që i interesojnë
- nuk është e sigurt lidhur me mënyrën se si ta zhvillojë lojën e saj
- ka nevojë të zhvillojë aftësitë e përqendrimit
- e sheh situatën si shumë stimuluese
- mund të ketë vështirësi të përgjithshme në të nxënë ose vështirësi të komunikimit shoqëror

Strategjitë:

- Përdorni metodën *High/Scope* ku Kloi të zgjedhë dy ose tre aktivitete që ajo duhet t'i kryejë. Ajo mund të ketë nevojë për ndihmën e një të rrituri fillimisht. (Për informacion të mëtejshëm mbi metodën *High/Scope* shikoni Glenn *et al.* (2005) dhe për informacionet e kontaktit të Institutit *High/Scope* në Londër shikoni kapitullin “Adresa të nevojshme”.)
- Rregulloni për Kloin aktivitete loje të përshtatshme. Inkurajoni lojërat me imagjinatë dhe ofroni mbështetje gjuhësore, p.sh. “Hajde ta marrim kukullën dhe ta nxjerrim shëtitje” dhe “Hajde ta çojmë kukullën në shtëpi dhe ta vëmë në gjumë”.
- Mbështeteni Kloin që të luajë përkrah fëmijëve të tjerë. Fillimisht ajo duhet të jetë me një fëmijë dhe duhet t'i jepet një detyrë e shkurtër e përcaktuar si “Mundohu të bësh një makinë me kuba”. Është shumë e rëndësishme që të monitorohen këto lloj aktivitete me kujdesin më të madh për të arritur një kuptim më të mirë të mënyrës me të cilën Kloi i bën aktivitetet
- Kloi gjithashtu mund të ketë një kuptim të limituar të gjuhës. Mund të jetë i dobishëm përdorimi i ndihmësve figurativë siç janë figurat dhe fotografitë.

RASTI STUDIMOR 2

Një fëmijë që është agresiv ndaj të tjerëve ndërsa luan/u ndërhyr në të tjerëve

Xhemi në përgjithësi, kur është në parashkollë, luan vetëm. Ai kënaqet më shumë kur është duke luajtur me pajisjet e ndërtimit dhe ka shumë imagjinatë. Ai mund të ndërtojë struktura shumë të komplikuar dhe të t'i shpjegojë ato shumë lirshëm. Të rriturit e lavdërojnë gjithnjë për projektet që ndërton. Problemi fillon kur fëmijët e tjerë vijnë të luajnë me lodrat e ndërtimit, veçanërisht kur njëri prej tyre arrin të ndërtojë një model shumë të mirë. Xhemi është parë të reagojë duke thyer modelin e ndërtuar nga fëmija tjetër dhe duke i marrë atij pjesët që i duhen për vete. Në disa raste ai edhe ka qëlluar fëmijën tjetër duke i bërtitur që të largohet pasi është ai që po i përdor pajisjet e ndërtimit.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Xhemi:

- dëshiron t'i marrë në mënyrë individuale lavdërimet për ndërtimin e modeleve të bukura. Ai nuk do që edhe fëmijët e tjerë të marrin lavdërimet.
- e di që është shumë i mirë në ndërtimin e modeleve dhe ndoshta ndien se nuk është i zoti të bëjë gjëra të tjera. Ai do që të ndiejë se modelet e bukura janë diçka që vetëm ai mund ta bëjë. Kjo është mënyra e Xhemit për të ruajtur vetëvlerësimin, të cilin mund ta ketë shumë të ulët në fusha të tjera
- nuk ka mësuar akoma të ndajë gjërat me të tjerët
- nuk është mësuar të ndajë pajisjet me të tjerët pasi pajisjet e ndërtimit që ka në shtëpi ai i përdor vetëm

Strategjitë:

- Inkurajojeni Xhemin që t'u tregojë njerëzve se si i ndërton ai gjërat kaq mirë dhe t'i 'ndihmojë' ata të ndërtojnë modelet e tyre. Në fillim ai mund të 'ndihmojë' një të rritur
- Lavdërojeni Xhemin për përpjekjet që bën në fusha të tjera në parashkollë. Theksi duhet vënë mbi rëndësinë e faktit që ai provon apo përpiqet të bëjë gjëra të reja.
- Inkurajojeni Xhemin që t'i ndajë me të tjerët pajisjet, fillimisht me një nga fëmijët. Ndarja e gjërave me të tjerët mund të jetë shumë e vështirë për disa fëmijë dhe fillimisht ata do të kenë nevojë për lavdërimet për çdo bashkëndarje, sado të vogël. Mund të ndihmojnë aktivitetet në të cilat duhet pritur radha, ku pajisjet janë ndarë paraprakisht dhe çdo person duhet të presë radhën, p.sh. ndërtimi i një kulle me tulla

RASTI STUDIMOR 3

Një fëmijë që nuk do të ndajë gjërat me të tjerët

Keri i pret me padurim mëngjeset kur shkon në parashkollë dhe mamaja e saj thotë që ajo e vesh vetë pallton sapo zgjohet! Në parashkollë Keri vazhdimisht merr pa leje lodrat nga fëmijët e tjerë dhe i qëllon ata me grusht për t'i hequr qafe. Kerit i pëlqejnë në mënyrë të veçantë rrëshqitëset dhe nuk arrin të presë derisa të jetë radha e saj. Ajo i shtyn fëmijët teksa janë duke ngjitur shkallët ose duke u bërë gati për të rrëshqitur dhe ka shkaktuar një sërë aksidentesh. Në aktivitetet ulur në tavolinë Keri mbledh menjëherë të gjitha lodrat, bojërat etj. dhe thotë “janë të miat”. Shumë nga fëmijët mërzhiten shumë por Keri nuk duket e shqetësuar nga të qarat e tyre.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Keri :

- e ka shumë të vështirë të ndërveprojë shoqërisht me fëmijët e tjerë dhe të kuptojë faktin që edhe ata duan të luajnë
- ka një nivel shumë të lartë kontrolli brenda familjes së saj dhe do që ta ruajë këtë edhe në ambientet e parashkollës.
- ka vështirësi me aftësitë motorike dhe lëvizjet e saj duken të pakoordinuara dhe të rrezikshme në disa raste

Strategjitë:

- Monitoroni sjelljet e Kerit me fëmijët e tjerë për të përcaktuar nëse ajo merr ndonjë iniciativë për ndërveprim. Mund të jetë e dobishme të pyeten prindërit e saj nëse kjo sjellje ndodh edhe në shtëpi
- Bëni një vlerësim të mëtejshëm për të parë nëse ka ndonjë problem mjekësor si vështirësi motorike, probleme të dëgjimit, vështirësi të komunikimit shoqëror ose vështirësi me përqendrimin
- Implementoni një program specifik në mënyrë që Keri të kalojë një pjesë kohe individuale me një të rritur në çdo seancë dhe të mund të monitorohet ritmi i saj në të nxënë të gjërave të reja.
- Mbështeteni atë në aktivitetet me pritje radhe në mjedise dyshe në mënyrë që ajo ta dallojë që i duhet të mbajë radhën

RASTI STUDIMOR 4

Një fëmijë që i përdor pajisjet në mënyrë të papërshtatshme, vë sendet në radhë, nuk ka kujdes për asgjë

Mamaja e Semit shpesh i tregon personelit të parashkollës se sa i mirë dhe i qetë është ai në shtëpi dhe se ai mund të luajë shumë i lumtur për orë të tëra dhe “ti as nuk do ta vije re që është aty”. Në parashkollë, personeli ka vënë re që Semi luan gati gjatë gjithë ditës vetëm. Atij i pëlqejnë shumë trenat dhe ulet i kënaqur e i vë ata në radhë, pastaj i vendos përsëri në kuti dhe pastaj i nxjerr e i vë përsëri në radhë. Ai mërzhitet nëse ndonjë fëmijë tjetër vjen të bashkohet me të për të luajtur. Në këto raste ai i hedh pajisjet nëpër dhomë, zakonisht duke marrë në shënjestër fëmijët e tjerë. Përfundimisht ai ka qejf të luajë me zhavorrin e rrugëve. Në qoftë se dikush vjen drejt tij, ai fillon ta godasë me zhavorr.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Semi:

- ndihet i sigurt kur ka në parashkollë pajisje të njëjta me ato që ka në shtëpi
- e ka të vështirë të luajë me imagjinatë. Ai kënaqet me sigurinë që i japin lodrat me të cilat është familjarizuar. Kjo duhet monitoruar pasi mund të jetë tregues i vështirësive të këtij fëmije në komunikimin shoqëror (dhe ndoshta edhe i autizmit)
- nuk ka mësuar të ndajë pajisjet me të tjerët dhe nuk di si të sillet kur të tjerët duan të bashkohen në lojë me të
- është një fëmijë me shumë ankth

Strategjitë:

- Hartoni programe specifike për ta ndihmuar Semin që të zgjerojë gamën e tij të aktiviteteve. Ka shumë mundësi që ai të ketë nevojë për mbështetjen e një të rrituri që t’i tregojë se si të luajë me lodrat dhe pajisjet e tjera
- Lejojeni Semin që të ndjekë aktivitetet që ai pëlqen më shumë por kontrollojeni këtë proces. Për shembull, Semi mund t’i mësohen rregullat e lojës me aktivitete të tilla si “së pari vizatimi, më pas makinat”. Kjo mund të bëhet nëpërmjet metodës së një orari të dukshëm të aktiviteteve në mënyrë që Semi të familjarizohet me pritshmëritë. Është shumë e rëndësishme që Semi t’i lejohej të bëjë aktivitetet që ka përzgjedhur dhe kjo mund të përdoret si shpërblim për sjellje të mirë.
- Diskutojini aktivitetet e Semit me prindërit e tij. Ai mund të ketë nevojë për vlerësime të mëtejshme. Do të jetë e rëndësishme që të monitorohen ndërveprimet e Semit me fëmijët e tjerë dhe metoda e tij e komunikimit me të tjerët.

RASTI STUDIMOR 5

Një fëmijë që nuk luan me imagjinatë

Nëna e Robertit informoi personelin e parashkollës se Roberti gjithnjë është shumë i përfshirë në lojë dhe mund të luajë për orë të tëra në shtëpi me makinat apo trenat e tij. Personeli i parashkollës vuri re se kjo ishte situata edhe në këtë ambient dhe se ishte shumë e vështirë ta ndërprisje Robertin pasi kishte filluar të luante. Roberti gjithashtu kishte shumë qejf këndin e shtëpisë dhe harxhonte shumë kohë me lavatriçen. Kur Roberti u vëzhgua nga afër, personeli vuri re se ai merrte e i vinte makinat në radhë në mënyrë shumë metodike, pastaj fliste me vete e më pas i mblidhte makinat me kujdes dhe i vinte në të njëjtin rend si më parë. Kjo ndodhte edhe me trenat. Në këndin e shtëpisë Roberti mbush lavatriçen me rroba dhe më pas merr e i heq rrobat në rendin e kundërt. Ai e bënte këtë disa herë rresht.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Roberti :

- kënaqet me njëtrajtshmërinë dhe strukturën e aktiviteteve që ai përzgjedh
- i bën këto aktivitete në shtëpi dhe i përsërit edhe në kopsht. Në këtë mënyrë ai ndihet i sigurt
- mund të ketë vështirësi dëgjimi ose në të kuptuarin e gjuhës, ose vështirësi në komunikimin shoqëror
- po përpiqet të gjejë kuptimin e ngjarjeve të jetës së tij

Strategjitë:

- Përfshijeni Robertin në një diskutim mbi makinat, trenat ose rrobat e tij dhe inkurajojeni që të lejojë një të rritur të ndajë aktivitetin me të. Në këtë mënyrë ai mund të fillojë të flasë rreth lojës së tij. Nëse do të ketë ndonjë shqetësim, ky mund të diskutohet me prindërit apo kujdestarët e Robertit
- Ftojini Robertin të zgjedhë një makinë ose një veshje dhe t'i përdorë ato në një mënyrë të ndryshme, si për shembull të përdorë makinën me një garazh ose të veshë një arush me rrobën që zgjodhi
- Merrini pajisjet përjashta dhe larg ambientit të zakonshëm brenda parashkollës
- Lejoni një arush apo një kukull të bashkohet si fillim në lojë për të inkurajuar pritjen e radhës

RASTI STUDIMOR 6

Një fëmijë që nuk përfshihet në lojën e roleve

Anëtarëve të personelit të parashkollës u pëlqen të krijojnë situata loje për fëmijët e tyre. Më parë ata kanë pasur një shpellë, një dyqan, një tren, një cirk dhe një varkë mes shumë lodrave të tjera. Nardi nuk arrin të kuptojë se si dikush mund të mendojë që një kuti e lyer me bojë të jetë varkë. Ai u thotë fëmijëve të tjerë “Kjo është një kuti, ne e kemi lyer atë. Nuk është varkë.” Fëmijët e tjerë i thonë Nardit “Jo, kjo është varkë,” “Hajde të bëhesh pirat.” Nardi në të tilla raste mërzitet shumë e i hipin nervat dhe vrapon tek anëtarët e personelit.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Nardi :

- nuk i ka zhvilluar akoma aftësitë e të menduarit imagjativ. Aftësitë e tij janë shumë të fokusuara në nivelin konkret
- ka ankth në situata imagjinare
- mund të ketë pasur eksperiencë të limituara përjashta shtëpisë së tij
- inkurajohet shumë në shtëpi për t’u sjellë “si i rritur” dhe i duket se lojërat ‘me gjasme’ janë për bebet

Strategjitë:

- Tregojini Nardit varka dhe fotografi rreth situatave të ndryshme të lojës për të parë nëse ai mund të përfshihet në tregime. Atij duhet t’i bëhen pyetje të tilla si “Çfarë mendon se do të ndodhë më pas?” ose “Çfarë do të ndodhte nëse?”
- Jepini Nardit mundësinë që të shohë varka të vërteta, trena si dhe mundësinë për eksperiencë të tjera. Ai mund të mos i ketë përjetuar këto situata në jetën e vërtetë dhe kjo mund t’ia bëjë atij shumë të vështirë t’i imagjinojë ato dhe të luajë me to
- Shikoni së bashku librat dhe flisni mbi çfarë po ndodh nëpër piktura. Nardi në fillim mund të shohë fëmijët e tjerë të cilët luajnë rolet e tregimeve të librave. Gradualisht, ai mund të përfshihet më tepër dhe të bashkohet me këto aktivitete
- Vini në skenë tregimet me Nardin duke përdorur kukulla
- Mësoni nga prindërit/kujdestarët e Nardit rreth tregimeve që janë pjesë e traditave të tyre kulturore dhe përdorini disa nga ato si një pikënisje për lojërat me imagjinatë

RASTI STUDIMOR 7

Një fëmijë që ka frikë të përfshihet në aktivitete me ngjitje/fizike

Hamish shikon ndërsa fëmijët e tjerë kënaqen duke luajtur në rrëshqitëse dhe në pajisjet e mëdha. Atij duket se ia ka qejfi ta provojë edhe vetë por, nëse një i rritur apo një fëmijë tjetër i afrohen dhe e ftojnë, ai thjesht rri aty dhe thotë “Jo” dhe kthen kokën dhe trupin në krahun tjetër.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Hamish ndoshta:

- ka pasur një eksperiencë të keqe ose ka rënë në të shkuarën dhe ngurron ta provojë përsëri
- ka prindër/kujdestarë që e ruajnë shumë dhe shqetësohen nëse ai përfshihet në shumë aktivitete fizike
- mendon se do të bjerë
- ka probleme të integritetit të shqisave
- është dispraksik ose “i ngathët”
- tërheq më shumë vëmendje nëse nuk përfshihet në aktivitete dhe kjo i është kthyer tashmë në një model sjelljeje

Strategjitë:

- Flisni me prindërit/kujdestarët e Hamish për të parë nëse ka ndonjë arsye për shqetësimin e tij
- Hartoni një program për të ndihmuar zhvillimin e aftësive motorike. Do të ishte e dobishme të zbulohet nëse Hamish ka bërë ndonjë kontroll tek mjeku. Nëse jo, atëherë kjo i duhet sugjeruar prindërve të tij
- Lejojeni Hamish që të luajë në pajisjet kur fëmijët e tjerë nuk janë atje në mënyrë që të krijojë vetëbesim
- Jepini atij shumë inkurajime dhe mbështetje dhe lavdërojeni kur luan në pajisjet e mëdha

RASTI STUDIMOR 8

Një fëmijë që nuk tregon frikë ose është impulsiv

Xhekut i pëlqejnë shumë lodrat e mëdha dhe loja përjashta në parashkollë. Ai vazhdimisht vrapon direkt për tek dera dhe del përjashta në zonën e lojës. Xheku ngjitet në pajisjet dhe kërcen nga maja duke harruar, me sa duket, çdo rrezik. Është vrarë disa herë por kjo nuk e ka dekurajuar. Ai është aq i shpejtë saqë personeli e ka shumë të vështirë ta ketë gjithnjë parasysh se ku ndodhet.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Xheku:

- ka energji të tepërta dhe përdor të gjitha shanset për të luajtur përjashta. Ai mund të ketë hapësira të kufizuara për këto lloj lëvizjesh në shtëpi
- ka vështirësi të hiperaktivitetit dhe një interval përqendrimi të shkurtër. Ai nuk arrin t'i kuptojë pasojat e veprimeve të tij
- ka vështirësi në integrimin e shqisave
- mund të ketë vështirësi në të nxënë ose vështirësi në komunikimin shoqëror

Strategjitë:

- Përdoreni lojën fizike përjashta si shpërblim për sjelljen e mirë. Në këtë mënyrë, loja përjashta do të kontrollohet nga personeli i parashkollës në vend që të lihet në dorë të Xhekut. Një sugjerim do të ishte që atij t'i jepet një copë letre e plastifikuar, e ndarë në katër segmente. Atij do t'i thuhet që, nëse bën diçka të mirë, një nga personeli do t'i vërë një fytyrë të qeshur në letër. Kur ai të ketë fituar katër fytyra të qeshura atëherë mund të dalë për të luajtur përjashta për pesë minuta (sipas orës me zile). Fillimisht është e rëndësishme që letra e Xhekut të mbushet disa herë në të njëjtën seancë, në mënyrë që ai të familjarizohet me këtë proces. Shpërblejeni atë për të gjitha gjërat e vogla që bën, si p.sh. kur buzëqesh me mirësjellje apo kur lëviz me kujdes.
- Kontrolloni sjelljen e Xhekut në fusha të tjera për të përcaktuar nëse ka vështirësi të përqendrimit. Do të jetë e dobishme të diskutohen këto sjellje me prindërit/kujdestarët
- Diskutoni sjelljen e Xhekut me një mjek profesionist. Ai mund të ndikohet nga elemente të ushqimit
- Xhekut mund të mos i jetë mësuar që të marrë parasysh pasojat e veprimeve të tij. Hartoni një program specifik që fokusohet tek pasojat. Kjo mund të bëhet nëpërmjet figurave apo librave me tregime
- Aplikoni një sistem të strukturuar aktiviteteve të cilat shpërblehen me kohë të kaluar përjashta. Kjo mund të realizohet me një matës të kohës vizual ose konkret të tillë si p.sh. t'i tregohen Xhekut kubat dhe t'i thuhet, "Më parë kubat, pastaj rrëshqitësja". Kjo është e nevojshme të ndërtohet si një model për Xhekun, në mënyrë që atij t'i duhet të kryejë një aktivitet të shkurtër shumë specifik përpara se të luajë përjashta ose tek pajisjet e mëdha. Ky lloj sistemi ka nevojë për mbështetjen e të rriturve që të ndërtohet dhe të ruhet.

RASTI STUDIMOR 9

Një fëmijë që i shmanget lodrave të tilla si biçikletat dhe motorët

Shanon ulet shumë e lumtur në një nga tavolinat e punës së dorës në këndin e librave. Ajo luan në këndin e shtëpisë dhe ka shumë qejf plastelinën. Shanon asnjëherë nuk përzgjedh lodrat mbi të cilat duhet të ulesh dhe nuk është parë asnjëherë të shtyjë karrocën me kukulla. Mamaja e saj thotë që Shanon akoma ulet në karrocë kur ato dalin për shëtitje.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Shanon:

- lodhet nga këto lloj aktivitete. Kjo mund të kërkojë një kontroll mjekësor, veçanërisht nëse Shanon ka nivel energjie të ulët në fusha të tjera
- ka pasur një eksperiencë të keqe me një nga lodrat me rrota në të shkuarën dhe kjo e ka frikësuar atë
- frikësohet nga paparashikueshmëria e fëmijëve kur ngasin këto mjete
- mund të ketë vështirësi të shikimit apo dëgjimit
- mund të ketë vështirësi të aftësive të mëdha motorike
- mund të jetë përfshirë ose ka parë një aksident motorik

Strategjitë:

- Inkurajojeni Shanon që të ulet në një triçikël pa e lëvizur atë
- Lejojeni Shanon që të provojë mjetet lëvizëse kur fëmijët e tjerë nuk janë përreth
- Lini një të rritur që ta shtyjë Shanon përreth si fillim, derisa ajo të fitojë më shumë besim
- Kontrolloni aftësitë motorike të Shanon dhe diskutojini shqetësimet tuaja me prindërit. Nëse është e nevojshme, prindërit e saj mund të kërkojnë një vlerësim të aftësive motorike nëpërmjet mjekut të tyre të familjes. Vështirësitë e dëgjimit dhe shikimit duhet gjithashtu të eliminohen
- Shikoni libra për makinat në situata grupesh të vogla ose individuale. Shanon mund të inkurajohet të flasë mbi makinat që ajo ka apo për të cilat di diçka

RASTI STUDIMOR 10

Një fëmijë që kundërshton të luajë në lojëra të organizuara apo udhëhequra nga të rriturit

Beni ka shumë dëshirë të luajë me lodrat dhe pajisjet në parashkollë dhe është shumë i kënaqur që ta kalojë kohën me shokët e tij duke përdorur mjetet me rrota të mëdha. E megjithatë, kur një i rritur afrohet te ai për ta pyetur nëse do të vijë tek tavolina dhe të bashkohet me lojën që po zhvillohet apo detyrat që po kryhen, ai refuzon ose bën një përpjekje me gjysmë zemre dhe pas pak largohet nga grupi. Kjo po i krijon probleme personelit sepse ata ndihen të paaftë për të vlerësuar nivelin e ecursisë së tij në lidhje me kurrikulën pasi ai bashkohet me ta shumë rallë tek tavolina e shkrimit ose e matematikës.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Beni:

- nuk është gati për të marrë pjesë në detyra të formalizuara. Sjellja e tij mund të jetë një pasqyrim i nivelit të tij të përgjithshëm të të kuptuarit
- është i ndërgjegjshëm që detyrat e drejtuara nga të rriturit mund të jenë shumë të vështira për të dhe, në vend që të shkojë dhe të dështojë, ai preferon të mos marrë pjesë
- nuk arrin të kuptojë se çfarë po i kërkohet të bëjë
- është mësuar të bëjë atë që do, kur ia do qejfi
- mendon se detyrat janë të mërzitshme në krahasim me lodrat që janë përreth në parashkollë
- nuk ka arritur nivelin e zhvillimit për të cilin këto detyra janë hartuar

Strategjitë:

- Jepini Benit më shumë kohë për të luajtur në një mënyrë të pastrukturuar dhe gjithashtu për të provuar më shumë forma fizike të të luajturit përpara se ai të ndihet gati për të marrë pjesë në stile më formale të të nxënies
- Udhëzoni të rriturit përreth Benit që të përdorin një gjuhë më të thjeshtë kur flasin me të, në mënyrë që ai të ketë më shumë shanse për të kuptuar fjalët kyçe dhe si rrjedhojë edhe atë që po i kërkohet
- Jepini Benit kufij dhe pritshmëri të qarta dhe theksojini ato çdo ditë. Atij mund t'i nevojitet që të ketë një nivel më të lartë perceptimi të pritshmërive që të rriturit në parashkollë kanë për mënyrat e sjelljes
- Sigurohuni që detyrat të pasqyrojnë një kurrikul të gjerë dhe të balancuar si dhe eksperiencat e fëmijëve. Shkrimi dhe matematika mund të organizohen po aq lehtësisht në mjediset e lojës në oborr dhe fëmijët që kanë vështirësi të ulen në tavolina shpesh japin rezultate më pozitive përjashta. Nëse përfshihen në aktivitete interesante përjashta, ka më shumë mundësi që ata të kenë më shumë dëshirë të mendojnë rreth koncepteve themelore si masa, format, ngjyrat, gjatësia etj. Për shembull, nëse Beni mund të vizatojë një kërmill dhe guaskën e tij në tabelën e oborrit me shkumës dhe ta krahasojë gjatësinë e tij me atë të kërmillave të tjerë që janë mbledhur nga fëmijët, personeli do të krijojë një ide të mirë për nivelin e tij të përgjithshëm të të kuptuarit në fusha të ndryshme të kurrikulës.
- Përgatisni një Plan Edukimi Individual (PEI) për Benin, në mënyrë që të përmirësoni aftësinë e tij për të marrë pjesë në aktivitete të udhëhequra nga të rriturit (shiko Shtojcën 1)

RASTI STUDIMOR 11

Një fëmijë që luan gjithmonë rolin e mamasë në këndin e shtëpisë

Viktorja ka shumë dëshirë të vishet me kostume dhe të luajë në këndin e shtëpisë. Asaj i pëlqen t'i zgjedhë vetë fëmijët me të cilët do të luajë dhe gjithmonë ajo duhet të luajë rolin e 'mamasë'. Në fakt, sa herë që luan këtë lojë, ajo insiston që të jetë në komandë dhe dominon lojën. Nëse një fëmijë tjetër përpiqet të ushtrojë ndonjë lloj kontrolli, Viktorja mërzitet shumë dhe nuk arrin ta pranojë situatën. Në disa raste, ajo ka ndërhyrë në mënyrë fizike, p.sh. duke e shtyrë fëmijën tutje, për të bërë të qarta ndjenjat e saj.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Viktorja :

- është duke luajtur rolin ashtu siç e koncepton ajo sjelljen e mamasë së saj
- do të ketë kontroll të plotë mbi atë që po bën dhe nuk i pëlqen pasiguria e të mosditurit se çfarë do të ndodhë
- ka një personalitet dominues
- mund të jetë një fëmijë shumë i aftë
- ndoshta është fëmija e parë e familjes dhe në shtëpi i jepen shumë përgjegjësi
- mund të jetë më e vogla e shtëpisë dhe është duke përdorur situatën e parashkollës për të rregulluar balancën

Strategjitë:

- Jepini Viktorjas mundësinë që të provojë intervale të shkurtra në të cilat dikush tjetër është 'mamaja'. Ajo mund ta zgjedhë vetë se kush duhet ta luajë këtë rol, në këtë mënyrë do të vazhdojë të ketë njëfarë kontrolli. Inkurajojeni atë që ta lejojë fëmijën tjetër të bëjë 'mamanë' për një periudhë të caktuar kohe, p.sh. derisa ora e rërës të mbarojë. Më pas Viktorja mund të luajë prapë rolin e mamasë për të njëjtën sasi të shkurtër kohe. Ajo duhet të inkurajohet që të shprehë se çfarë i pëlqeu nga eksperiencia e të *mosqenit* mamaja
- Inkurajojeni Viktorjan të luajë lojëra të tjera në mënyrë që aftësitë e saj për të luajtur të zgjerohen
- Inkurajojeni Viktorjan të zgjerojë rrethin e shokëve
- Sigurohuni që plani mësimor i Viktorjas të jetë sfidues dhe burimet stimuluese për të.
- Lejojeni Viktorjan t'i përdorë aftësitë e saj udhëheqëse në fusha të tjera të të nxënës, p.sh. jepini asaj përgjegjësi të cilat inkurajojnë dhe zgjerojnë aftësitë e saj ndërpersonale, ose kanalizoni instiktet e saj të natyrshme për të qenë në komandë duke i dhënë mundësi të ndihmës të rriturit me detyra të dobishme organizative
- Bisedoni me Viktorjan që ajo të lërë fëmijët e tjerë të luajnë rolin e mamit dhe jepini asaj arsyet përse kjo është një ide e mirë

RASTI STUDIMOR 12

Një fëmijë që nuk dëshiron t'i lërë të tjerët të luajnë të njëjtën lojë me të

Alketës i pëlqen të luajë me një karrocë fëmijësh të caktuar dhe një kukull. Asaj i pëlqen të luajë me këto dy lodra për shumicën e kohës. Ajo jo vetëm që insiston të ketë të njëjtën karrocë dhe të njëjtën kukull, por gjithashtu ka dëshirë që ta nxjerrë kukullën shëtitje në të njëjtin drejtim përreth oborrit. Nëse një fëmijë tjetër përpiqet të bashkohet me të, Alketa inatoset shumë, duke e shtyrë fëmijën tutje. Alketa i referohet kësaj karroce të caktuar dhe kukullës si “bebi im”.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Alketa ndoshta:

- ka nevojë për sende që ta bëjnë të ndihet e sigurt
- nuk ka karroca fëmijësh dhe kukulla me të cilat të luajë në shtëpi
- ka aftësi për të luajtur shumë të limituara
- nuk është e kënaqur të jetë larg nga shtëpia dhe nga mamaja e saj dhe kjo lojë e përsëritur është një burim ngushëllimi dhe sigurie

Strategjitë:

- Hiqini karrocën për fëmijë nga përdorimi për një pjesë të kohës
- Inkurajoni Alketën të luajë përkrah një të rrituri i cili do të modelojë aftësitë për të luajtur nëpërmjet lodrash të ndryshme
- Vëzhgojeni Alketën duke luajtur me lodra të ndryshme, veçanërisht me pajisjet e ‘lojës së roleve’, dhe përdorini ato për t’iu adresuar fushave të ndryshme që kanë nevojë për ndihmë
- Bashkoni Alketën me një fëmijë tjetër që ka aftësi shumë të mira për të luajtur dhe krijoni situata të tilla që të inkurajojnë dhe zgjerojnë interesat e Alketës në lodra të tjera

RASTI STUDIMOR 13

Një fëmijë që nuk arrin të pranojë humbjen e një loje (mos u nxeh)

Sokolin duhet ta shohin duke fituar çfarëdo që të jetë duke luajtur. Kjo bëhet shumë e dukshme kur luhen lojëra më të organizuara si loto ose mos u nxeh. Nëse loja merr një kthesë pak negative, p.sh. nëse Sokoli duhet të kthehet mbrapsht kur e djegin në lojën mos u nxeh dhe duhet të fillojë nga e para me një nga gurët, ai shpesh largohet nga tavolina dhe kundërshton që ta vazhdojë lojën. Ndërsa, kur gjërat ecin në favor të tij, ai e mbaron lojën me qejf.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Sokoli :

- nuk është i aftë të përballojë asnjë lloj kritike apo humbjeje
- është mësuar që t'i ecë gjithmonë e tija
- e shikon çdo lloj kthimi mbrapa në mënyrë shumë të ekzagjeruar
- ka vetëvlerësim shumë të ulët dhe ngatërron humbjen e lojës me një fyerje personale
- nuk ka pasur rast të humbi ndonjëherë në jetën e tij dhe ka qenë i mbrojtur nga çdo gjë negative
- nuk arrin ta kuptojë plotësisht lojën

Strategjitë:

- Shpjegojani dhe, nëse është e mundur, demonstrojani lojën fëmijëve përpara se të fillojnë të luajnë, duke përdorur një gjuhë shumë të thjeshtë. Mos supozoni që fëmijët e dinë lojën apo e kuptuan atë menjëherë
- Shpjegojuni që ndonjëherë është e nevojshme të bësh hapa mbrapa (si në lojën mos u nxeh kur të djegin gurin) dhe që gjithmonë ekziston një mundësi për të fituar prapë pikë dhe që edhe njerëzit e tjerë do të bëjnë hapa mbrapa
- Përdorni tregime shoqërore dhe lojë me role. Kjo mund ta ndihmojë Sokolin që të mësohet me idenë që ndonjëherë do të ndodhin edhe gjëra negative dhe që ekziston gjithmonë mundësia për t'i përballuar ato
- Kushtojini vëmendje mënyrës se si Sokoli sillet në situata të tjera për të parë nëse kjo lloj sjelljeje është pjesë e një modeli të përgjithshëm sjelljeje. Nëse kjo është e vërtetë, vetëvlerësimi i Sokolit mund të jetë i ulët. (Shiko librin tonë të parë *Sjellja në Fëmijërinë e Hershme* (Glenn et al. 2004)
- Inkurajojeni Sokolin që të ndajë gjërat mbi të cilat ka kontroll nga ato mbi të cilat nuk ka

RASTI STUDIMOR 14

Një fëmijë që nuk arrin të luajë sipas rregullave të caktuara

Andi është shumë i kënaqur të luajë me fëmijët e tjerë dhe ka tre djem me të cilët i pëlqen të luajë në mënyrë të veçantë. Por, sapo loja fillon të bëhet intensive dhe gjithëpërfshirëse dhe është e nevojshme të aplikohen rregullat, p.sh. “Ti nuk je i lejuar të më kapësh kur unë jam mbrapa kësaj pemës”, Andi duket se i shkel rregullat me qëllim. Gati gjithmonë lojërat përfundojnë në sherr. Kur një i rritur është duke prezantuar rregullat e një loje të realizuar në tavolinë, Andi shpesh e injoron këtë dhe me qëllim bën lëvizje në të gjitha drejtimet që atij ia ka qejfi. Edhe pse të rriturit përfundojnë që ta përjashtojnë nga loja, ai gjithmonë bën rrëmujë të madhe për këtë.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Andi:

- krijon një ‘dramë’ me qëllim sepse i pëlqen t’i kushtojnë vëmendje
- do që të jetë vetë në komandë dhe nuk duron dot që të tjerët të vendosin rregullat e lojës
- nuk arrin të kuptojë idenë e ekzistencës së rregullave dhe përse ato janë të nevojshme
- nuk është mësuar të ndjekë rregulla të krijuara nga të tjerët
- është mësuar që t’i dalë e tija
- ka kuptuar që, nëse reziston për një kohë të mjaftueshme, atëherë përfundimisht do t’i dalë e tija

Strategjitë:

- Shpjegojini përse për të luajtur disa lojëra nevojiten rregullat
- Inkurajojeni Andin që të krijojë vetë disa rregulla për lojërat të cilat të tjerët do t’i ndjekin. Shokët e tij mund të bëjnë të njëjtën gjë dhe Andit pastaj do t’i duhet që të ndjekë rregullat e tyre.
- Bëjani shumë të qarta pasojat e të mosluajturit apo të mosrespektimit të rregullave
- Flisni me Andin për situatat në të cilat neve na duhet t’u bindemi rregullave, p.sh. në semaforët e rrugës, dhe çfarë do të ndodhte nëse njerëzit nuk do t’u bindeshin atyre

RASTI STUDIMOR 15

Një fëmijë që nuk ka dëshirë të luajë përjashta

Ema gjithmonë zgjedh të luajë brenda edhe pse ekziston një politikë e “derës së hapur” në parashkollën e saj. Nëse të rriturit i mbushin mendjen që të dalë në oborr, ajo thjesht rri në vend dhe si përfundim gjen mënyrën për t’u kthyer brenda. Ndonjëherë të rriturit as nuk e vënë re që është kthyer përsëri brenda. Ema është një fëmijë e gjallë që të gjithë e duan, me një humor të këndshëm, dhe askush nuk arrin ta kuptojë zgjedhjen e saj për të luajtur gjithmonë brenda.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Ema:

- është shumë e interesuar në lodrat dhe pajisjet që ndodhen në dhomat brenda
- nuk ndihet e sigurt përjashta
- frikësohet nga disa prej aktivitetëve përjashta
- nuk dëgjon apo shikon qartë çfarë ndodh përjashta
- ndoshta nuk ka oborr në shtëpi dhe është mësuar të luajë brenda
- mund ta lidhë qëndrimin përjashta me një eksperiencë të keqe që ka kaluar

Strategjitë:

- Organizoni një kontroll të dëgjimit dhe shikimit të Emës
- Mundohuni të gjeni se çfarë e tërheq Emën kaq shumë në aktivitetet në hapësirat e brendshme dhe çfarë e bezdis kaq shumë në aktivitetet përjashta. Nëse ka aktivitete apo pajisje të cilat janë të panjohura për të, të rriturit duhet që t’i tregojnë asaj përdorimin dhe ta inkurajojnë që të marrë pjesë, si fillim për periudha të shkurtra kohe
- Në mënyrë të rregullt, organizoni aktivitetet e preferuara të Emës në ambientet përjashta. Ajo do të mësojë që të bëjë një lidhje pozitive me hapësirat përjashta. Në të vërtetë, shumë natyrshëm, e gjithë seanca mund të organizohet jashtë.

RASTI STUDIMOR 16

Një fëmijë që luan vetëm me një fëmijë të caktuar

Jada luan vetëm me një fëmijë të caktuar në parashkollë. Nëse ky fëmijë mungon, atëherë Jada ulet vetëm. Ajo bashkëvepron me të rriturit dhe bashkohet në detyra të ndryshme por nuk luan me fëmijët e tjerë gjatë seancës së lojës së lirë. Kur shoqja e saj e veçantë është në parashkollë, Jada nuk ka dëshirë që fëmijë të tjerë të bashkohen me to.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Jada:

- është shumë e pasigurt
- mund të jetë përbuzur nga ndonjë fëmijë tjetër/grup fëmijësh dhe tani i mungon besimi për të luajtur me të tjerët
- po përpiqet të mbajë njëfarë kontrolli mbi atë që ndodh në parashkollë
- nuk është mësuar të rrijë me grupe të mëdha njerëzish
- është fëmijë i vetëm
- vjen nga një familje shumë e izoluar dhe një shoqe e vetme i mjafton

Strategjitë:

- Përfshijeni Jadën në aktivitete me grupe të vogla (ku të jetë vetëm një fëmijë tjetër fillimisht) si një element të zakonshëm të ditës dhe gradualisht rriteni përmasën e grupit
- Zbuloni interesat e Jadës dhe përdorini për ta përfshirë atë në punën në grup me fëmijët e tjerë
- Vëreni Jadën në çift me fëmijë të ndryshëm përgjatë orëve, në mënyrë që ajo të përballet me lloje të ndryshme karakteresh. Nëse Jadës i pëlqen të lidhet vetëm me një fëmijë dhe të gjitha rrugët e mundshme janë eksploruar, atëherë ndoshta kjo është pjesë e personalitetit të saj në këtë moment
- Zbuloni nëse ndonjë nga fëmijët e tjerë jeton afër me shtëpinë e Jadës për të zgjeruar raportet e saj jashtë parashkollës

RASTI STUDIMOR 17

Një fëmijë loja e të cilit është e përsëritur

Almiri i pëlqen të luajë me makina dhe trenat sa herë që i jepet mundësia. Ai vetëm sa i shtyn makinat para dhe mbrapa dhe të njëjtën gjë bën me trenat, edhe pse ndonjëherë përdor edhe shinat. Kur Almiri luan me topa, ai ka tendencën t'i hedhë kundrejt murit dhe duket se i pëlqen zhurma e përplasjes në mur. Almiri shpesh për zgjedh lodra dhe topa që bëjnë zhurmë. Në mënyrë të ngjashme, kur Almiri luan me triçiklat, ai zakonisht i përdor ato për t'i tundur para dhe mbrapa. Në këndin e shtëpisë Almiri vë të gjitha pjatat në një makinë larëse dhe pastaj thjesht i nxjerr të gjitha jashtë. Ai shpesh përsërit të njëjtin proces. Kur të rriturit apo fëmijët përqipen të flasin me Almirin, ai i injoron ata dhe shpesh shikon në drejtimin e kundërt ose në dyshe me.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Almiri:

- nuk ka shumë lodra në shtëpi
- ka mungesë eksperience, veçanërisht në lojën e roleve
- vuan nga çrregullimi i spektrit autist

Strategjitë:

- Vëzhgoni Almirin nga afër dhe vendosni nëse atij thjesht i mungon eksperiencia apo i nevojitet një kontroll pediatrik
- Modeloni aftësitë e lojës dhe inkurajoni Almirin, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë të fokusuar në fjalë kyçe sa më shumë që të jetë e mundur
- Përdorni ndihmës figurativë kurdo që të jetë e mundur për të maksimizuar aftësinë e Almiri për të kuptuar gjuhën
- Bëni vëzhgime dhe vlerësime për sa i përket të kuptuarit të gjuhës dhe koncepteve bazë nga Almiri dhe merrni në konsideratë të rekomandoni një vizitë tek terapisti i gjuhës dhe të folurit i cili mund të ndihmojë për të qartësuar nevojat e Almiri

RASTI STUDIMOR 18

Një fëmijë që përfshihet në lojë vetëm nëse drejtohet nga një i rritur

Xhena është një fëmijë e qetë e cila bashkëpunon me kërkesat e të rriturve dhe bashkohet me të gjitha aktivitetet në parashkollë. Megjithatë, është vënë re se ajo i bën të gjitha këto mbasi të ketë marrë udhëzime nga të rriturit dhe asnjëherë nuk vepron në mënyrë spontane. Kjo veçanti e sjelljes së saj është edhe më e dukshme kur ajo del përjashta dhe përgjatë orës së lojës së lirë. Të rriturit gjithmonë e gjejnë atë duke ndenjur vetëm dhe thjesht duke vëzhguar fëmijët e tjerë. Kur asaj i drejtohet dikush e i sugjeron të luajë me një lodër të caktuar, ajo i bindet sugjerimit dhe luan siç duhet.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Xhena:

- është një fëmijë shumë i qetë që preferon të vëzhgojë më shumë se sa të marrë pjesë
- nuk ka qejf të vijë në parashkollë por është edukuar që t'u bindet të rriturve
- mërzitet nga aktivitetet dhe nuk arrin t'u japë atyre një kuptim
- s'ka besim dhe mendon se është më e sigurt të presë derisa t'i kërkohej që të bëjë diçka për të mos bërë ndonjë gabim
- është mësuar të presë derisa t'i thuhet për të bërë diçka dhe ndoshta mendon se kjo është mënyra e duhur e sjelljes

Strategjitë:

- Butësisht inkurajojeni Xhenën që të kuptojë se, kur e ndjen veten gati, është e lirë të zgjedhë cilindo nga aktivitetet që janë në dispozicion. Nëse mendohet që Xhena është një fëmijë shumë i urtë dhe i pëlqen të vëzhgojë të tjerët, atëherë ajo duhet të lejohet ta bëjë këtë si pjesë e personalitetit të saj
- Caktoni një të rritur të besuar që të bëjë disa investigime të kujdesshme për të mësuar nëse Xhenës i pëlqen të vijë në parashkollë si dhe cilat janë interesat e saj personale. Nëse Xhena mundet t'i tregojë të rriturit se çfarë i pëlqen të bëjë, ndoshta këto gjëra mund të përfshihen në orët e mësimi në mënyrë që Xhena të ndiejë se mendimi i saj është i rëndësishëm dhe se ka diçka të mirë për ta pritur me qejf.
- Jini të mirëinformuar mbi zhvillimin e aftësive të saj njohëse dhe gjykoni nëse asaj i ofrohen sfida të mjaftueshme për t'i ngjallur interesin

RASTI STUDIMOR 19

Një fëmijë që gjithmonë kërkon (mban përdore) një të rritur gjatë lojërave përjashta

Tina gjithmonë i ngjitet nga pas një të rrituri duke i mbajtur dorën kur është përjashta dhe përpiqet që të rrijë me atë person gjatë gjithë orës. Kur fëmijë të tjerë i afrohen dhe i kërkojnë që të bashkohet me ta, ajo i ngjitet edhe më shumë të rriturit, duke ia shtrenguar dorën edhe më fort. Të gjitha sugjerimet dhe inkurajimet nga personeli për ta përfshirë Tinën në aktivitetet që janë duke u zhvilluar kanë dështuar.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Tina:

- është e frikësuar nga pajisjet që ndodhen përjashta të cilat (i) duken shumë të ndryshme nga ato që ajo përdor brenda
- mund të ketë probleme të dëgjimit dhe shikimit
- nuk ka besim tek vetja për të përdorur pajisje që janë më shumë fizike
- nuk ka eksperiencë në aktivitetet përjashta – mos banon në një apartament që nuk ka ndonjë dalje në oborr?
- është porositur që të rrijë patjetër me një të rritur kur është përjashta
- kërkon vëmendje – ndoshta ka një bebe të re në shtëpinë e saj?

Strategjitë:

- Jini të ndërgjegjshëm për ndryshimin që kanë hapësirat e brendshme me ato të jashtmet. Aktivitetet që organizohen brenda në parashkollë duhet të jenë të ndërkëmbyeshme me aktivitetet përjashta. Për shembull, vizatimi nuk është e thënë që duhet të realizohet vetëm në ambientet e brendshme, shumë lehtë mund të transferohet në mjediset përjashta. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i shkallëve paralele mund të zhvillohet edhe në ambientet e brendshme. Në qoftë se Tinës i pëlqejnë më shumë aktivitetet ulur në tavolinë, këto mund të ofrohen edhe përjashta.
- Gradualisht inkurajojeni Tinën që të luajë me lodra me rrota dhe pajisje më të mëdha në mënyrë që personeli të ketë mundësi të bëjë një vlerësim për sa i përket aftësive motorike të mëdha dhe ekuilibrit të saj. Kjo duhet të bëhet fillimisht me ndihmën e të rriturve
- Pyesni prindërit e Tinës ose kujdestarët e saj nëse i kanë bërë ndonjë kontroll të shikimit dhe dëgjimit. Nëse dëgjimi dhe shikimi i saj janë normalë, personeli duhet ta inkurajojë që të zgjerojë përdorimin e pajisjeve duke ia prezantuar asaj këto një nga një dhe duke theksuar se sa zbatimës është përdorimi i tyre. Të rriturit duhet të demonstrojnë për Tinën përdorimin e pajisjeve
- Bashkoheni Tinën me një shoqe e cila të luajë me të një lojë të re të cilën ajo zakonisht nuk e luan, si p.sh. biçikletat me dy shala.
- Nëse Tina ka një bebe të re në shtëpi, inkurajojeni që të flasë për motrën/vëllain dhe lavdërojeni atë për ndihmën që i jep mamit etj.

RASTI STUDIMOR 20

Një fëmijë që mërzhitet kur vihet përpara situatash të panjohura

Antoni është katër vjeç e gjysmë dhe i pëlqen shumë të luajë dhe të marrë pjesë në detyrat e parashkollës dhe duket se i japin kënaqësi të gjitha aktivitetet që ofrohen. Megjithatë, nëse ora ka disa ndryshime ose në dhomë ndodhet një i rritur që ai nuk e njeh, Antoni fillon të qajë. Atij i duhet gjithmonë njëfarë kohe për t'u qetësuar dhe nevojitet një nivel i lartë mbështetjeje nga të rriturit për ta arritur këtë. Kur Antoni arrin të pushojë së qari, ai vazhdon sikur nuk ka ndodhur asgjë por herë pas here i afrohet një të rrituri për t'u siguruar. Antoni është sjellë në këtë mënyrë prej shumë kohësh aq sa të rriturit janë mësuar me këtë dhe tashmë e presin një sjellje të tillë prej tij dhe nuk u bën më përshtypje. Mamaja e Antonit akoma telefonon institucionin rregullisht për të pyetur rreth sjelljes së tij.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Antoni:

- ka mësuar që kur qan merr si rezultat vëmendje individuale
- mund të jetë vërtet i shqetësuar kur diçka e papritur ndodh dhe mund të bëjë një lidhje me një traumë të mëparshme
- mund të reflektojë ankthe që i ka mamaja e tij

Strategjitë:

- Organizoni një diskutim me mamanë e Antonit. Kjo mund të ofrojë një ide të qartë mbi çfarë ndodhet mbrapa sjelljes së tij
- Merrni në konsideratë edhe faktin që mund të jetë e nevojshme mbrojtja e fëmijës
- Paralajmërojeni Antonin kur e dini që do të keni një vizitor ose kur parashikohet të ndodhë diçka ndryshe nga rutina
- Vazhdoni ta mbështesni Antonin kur shqetësohet por mundohuni që t'i kushtoni gjithnjë e më pak kohë në të tilla raste. Të rriturit mund të reduktojnë mbështetjen e tyre në mënyrë graduale dhe të presin që Antoni të fillojë t'i përballojë këto situata me ndërhyrje minimale nga ana e të rriturve. Duhet vënë theksi në faktin se sa mirë po ecën Antoni vetëm dhe t'i jepet atij një shpërblim kur arrin t'ia dalë mbanë pa të rriturit
- Përdorni tregime rreth vizitorëve dhe surprizave për të nënvizuar aspektin pozitiv dhe të kënaqshëm të ngjarjeve të papritura

RASTI STUDIMOR 21

Një fëmijë që luan gjithmonë me lodra foshnjash

Samanta është katër vjeç dhe në parashkollë i pëlqen jashtë mase të luajë me fëmijë më të vegjël se vetja dhe gati gjithmonë përzgjedh aktivitete dhe lodra të projektuara për fëmijë më të vegjël ose edhe për foshnja. Sa herë që është ora e lojës së lirë, ajo gjithmonë shkon e zgjedh nga kutia që mban lodra të tilla si kubat dhe kutiat e formave. Ndonjëherë Samanta përzgjedh me qëllim figurat me copa të nivelit fillestar, me katër apo pesë copa, dhe në mënyrë të përsëritur fillon e i vë ato bashkë. Personeli nuk ka shqetësime për progresin e Samantës në fusha të tjera.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Samanta:

- nuk ka besim të mjaftueshëm në vetvete për të provuar aktivitete të reja
- ndihet e sigurt kur e di që do të jetë në gjendje t'i kryejë detyrat me lehtësi
- mund të mos ketë bërë shoqëri me fëmijë të së njëjtës moshë
- mund të ketë një vëlla/motër të vogël dhe luan me lodrat që i kujtojnë shtëpinë
- mund të mos ketë pasur shumëllojshmëri lodrash kur ishte shumë e vogël dhe po i zbulon ato për herë të parë
- mund të ketë vërtet frikë nga dështimi dhe përzgjedh gjëra të cilat e di që do të jetë e aftë t'i kryejë me sukses

Strategjitë:

- Organizoni vëzhgime të fokusuara për të parë se çfarë gjërash Samanta përzgjedh, me kë ndërvepron ajo dhe si
- Krijoni mundësi që një shoqe ta ndihmojë Samantën të integrohet me grupmoshën e saj
- Inkurajojeni Samantën të përfshihet në aktivitete më të përshtatshme për moshën e saj, fillimisht në grupe të vogla të fokusuara. Kjo mund të fillohet duke përdorur një lodër/pajisje që lidhet me aktivitetet e saj të preferuara por që është më e përshtatshme për nivelin e aftësive të saj
- Personeli duhet të nënvizojë gjërat në të cilat Samanta është shumë e mirë, nëse asaj i mungon besimi, dhe t'i japë asaj disa përgjegjësi në parashkollë
- Jepini Samantës të kuptojë që nuk ka problem nëse dështon – që të gjithë (duke përfshirë edhe të rriturit) bëjnë gabime ose që, kur ne bëjmë diçka për herë të parë, nuk është aq e lehtë dhe mund të mos arrijmë që me herën e parë ta bëjmë si duhet, dhe që kjo ndodh me të gjithë. Ajo mund të ketë nevojë që ta shikojë këtë fakt vetë me sytë e saj. Personelit mund t'i duhet të sajtojë situata në të cilat ata 'bëjnë gabime' dhe reagojnë ndaj kësaj në një mënyrë të qetë. Ajo mund të ketë nevojë të shohë njerëz që përpiqen të bëjnë të njëjtin aktivitet disa herë derisa të arrijnë rezultate
- Bisedoni me prindërit/kujdestarët e Samantës për të mësuar rreth preferencave të saj në lojë në mjedisin e shtëpisë.

RASTI STUDIMOR 22

Një fëmijë që del nga kontrolli ose eksitohet jashtë mase gjatë aktiviteteve të furishme

Heri është një djalë i shoqërueshëm të cilit i pëlqen të përfshihet në të gjitha aktivitetet në parashkollë. Ai është një fëmijë i sjellshëm e i bindur i cili ndjek udhëzimet dhe ka vetëbesim. Megjithatë, sa herë që organizohen aktivitete më shumë fizike dhe të vrullshme, Heri del nga kontrolli, është shumë i eksituar dhe duket se nuk arrin t'i dëgjojë të rriturit që i japin udhëzime mbi si duhet të sillet. Kjo ndodh veçanërisht kur ka aktivitete përjashta të cilat kërkojnë shumë lëvizje fizike. Zakonisht është babai që e sjell Herin në parashkollë dhe që vjen ta marrë. Është vënë re që, sapo Heri shikon babain, i hidhet atij dhe të dy fillojnë bëjnë 'mundje'.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Heri:

- i lidh orët aktive me një lloj situatë 'lirie të plotë' me shumë pak kufizime në sjellje
- e sheh orën aktive si një mundësi për të shkarkuar energjinë
- mund të ketë një nivel shumë të lartë energjie dhe gjen mënyrën për ta harxhuar në aktivitetet fizike
- mund të ketë një nivel të lartë sheqeri në gjak
- i lidh lojërat 'e rrëmujshme' me një 'faktor të fuqishëm argëtimi'

Strategjitë:

- Jini shumë të qartë lidhur me rregullat e sjelljes që duhen aplikuar gjatë aktiviteteve fizike dhe theksojini ato disa herë *përpara* se aktiviteti të fillojë. E mira do të ishte që rregullat të paraqiteshin në një formë figurative. Heri mund të ketë nevojë për një 'libër rregullash' të personalizuar
- Shpjegojini atij që, edhe pse disa njerëz e kanë qejf lojën e rëndë, jo të gjithë e pëlqejnë atë dhe për disa njerëz ajo është e frikshme. Gjithashtu, disa njerëz nuk kanë dëshirë që të shtyhen, të tërhiqen etj.
- Sigurohuni që aktivitetet e organizuara përjashta të mbulojnë të gjitha aspektet e kurrikulës dhe të mos fokusohen vetëm në aktivitetet më fizike. Në këtë mënyrë, fëmijët nuk do ta lidhin lojën përjashta me një mundësi të kufizuar zgjedhjeje të aktiviteteve
- Bisedoni me prindërit e Herit për sjelljen e tij për të parë nëse ai është njësoj në shtëpi. Nëse ata në shtëpi kanë të njëjtin problem, atëherë një plan veprimi i koordinuar midis familjes dhe parashkollës do të ndihmonte
- Jepini mundësi Herit të luajë rregullisht përjashta por në aktivitete të qeta
- Sigurohuni që Heri të dalë përjashta dhe të kryejë ushtrime fizike rregullisht dhe bisedoni me prindërit e tij për të kuptuar nëse ushqehet me një dietë të balancuar

RASTI STUDIMOR 23

Një fëmijë që nuk arrin të presë radhën e vet

Milo përfshihet me dëshirë në të gjitha aktivitetet e organizuara në parashkollë. Aq i pëlqejnë, sa nuk duron dot derisa t'i japin fjalën për t'u përgjigjur në seancat kur grupet janë sëbashku, shpesh duke u përgjigjur me zë të lartë përpara se i rrituri të ketë mbaruar së foluri. Gjatë lojërave Milo e ka shumë të vështirë që të presë derisa t'i vijë radha dhe futet i pari pa u lënë kohë njerëzve të tjerë që të ndërhyjnë. Milo vepron në mënyrë impulsive dhe duket se nuk mendon fare para se të bëjë diçka. Kur përfshihet në aktivitete fizike, Milo sillet në mënyrë shumë të rrezikshme duke u hedhur nga shkallët paralele pa paralajmëruar. Kur i tërhiqet vëmendja për një sjellje të tillë, Milo duket se nuk arrin të kuptojë se çfarë ka bërë gabim.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Milo ndoshta:

- është një individ shumë energjik i cili ka nevojë që ta drejtojë energjinë e tij në mënyrë më efektive
- nuk arrin të kuptojë rregullat shoqërore të sjelljes, p.sh. mbajtjen e radhës dhe të qenët i ndërgjegjshëm që njerëzit e tjerë kanë ndjenja që duhen marrë në konsideratë
- nuk e ka të qartë lidhjen midis veprimeve të tij dhe pasojave që ato sjellin
- vuan nga ADHD (çrregullim i mungesës së vëmendjes dhe i hiperaktivitetit)

Strategjitë:

- Bëni një listë të sjelljeve që përbëjnë shqetësim
- Kini parasysh çështjet e shëndetit dhe të sigurisë që lidhen me sjelljen impulsive të Milos
- Rekomandojeni Milon tek një pediatër për të eliminuar mundësinë e një arsyeje mjekësore për sjelljen e tij
- Aplikoni një planifikim shumë të mirë të kontrollit të sjelljes. Milo mund të ketë nevojë për një plan sjelljeje në mënyrë që personeli të jetë i koordinuar në punën për ta menaxhuar atë
- Bëjini të ditur Milos se cilat janë pritshmëritë tuaja përpara se aktiviteti të fillojë
- Vlerësojeni Milon kur ai demonstroi sjellje të pëlqyera
- Sigurohuni që Milo të përfitojë nga një strukturë e një niveli të lartë dhe nga një metodë mësimdhënieje e fortë figurative
- Bisedoni me Milon për pasojat e llojeve të ndryshme të sjelljes që ai të jetë i ndërgjegjshëm për rezultatet e veprimeve të tij. Përdorimi i kukullave dhe i tregimeve shoqërore mund të jenë dy mënyra për ta arritur këtë
- Përgatisni një PEI për Milon për të ndihmuar aftësinë e tij për të pritur radhën (shikoni Shtojcën 1)

RASTI STUDIMOR 24

Një fëmijë që nuk arrin të përshtatet me sugjerimet e të tjerëve gjatë lojës apo aktiviteteve

Lusi thjesht refuzon të marrë pjesë në lojërat nëse fëmijë të tjerë bëjnë sugjerime të cilat nuk përshtaten me të sajat. Në qoftë se rregullat e Lusit nuk përkrahen, ajo e ka të pamundur të vazhdojë të luajë. Lusi shpesh përfundon e mbuluar në lotë nga zemërimi kur nuk arrin t'i dalë e vetja dhe i duhet kohë që të qetësohet. Ajo e ka shumë të vështirë që të pranojë që nuk mund të jetë gjithmonë e para apo ajo që ka bërë vizatimin 'më të mirë'.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Lusi:

- është mësuar t'i ketë situatat nën kontroll
- ka dëgjuar gjithmonë t'i thonë që është më e mirë se fëmijët e tjerë në të gjitha gjërat që bën
- mund të jetë fëmijë e vetme ose më e vogla e shtëpisë dhe, për këtë arsye, është e llastuar
- ka kuptuar që, kur insiston për gjërat ose qan, arrin atë që do

Strategjitë:

- Jepini Lusit një vlerësim realist për arritjet e saj. Pikat e saj të forta duhen theksuar
- Ndihmoheni Lusin të kuptojë që është një gjë pozitive të dëgjosh të tjerët dhe që të tjerët kanë gjëra të vlefshme për të thënë. Tregimet shoqërore mund të vijnë në ndihmë ose mund të përdoret koha në grup për ta diskutuar çështjen në mënyrë anonime. Për të mësuar më shumë rreth tregimeve shoqërore kontaktoni shërbimet e këshillimit të parashkollës. Bibliotekat kanë një gamë të gjerë librash që trajtojnë subjekte specifike në disa fusha.
- Jepini Lusit kontroll mbi atë që po ndodh. Ajo mund të lejohet të zgjedhë një shoqe që të bashkohet me një grup që po luan një lojë të thjeshtë. Vendimi se kush duhet të luajë e para mund të bëhet nga i gjithë grupi në mënyrë që të gjithë fëmijët të kenë një mundësi për të komanduar. Kështu (kur ekzistojnë rregulla të përcaktuara) Lusi do të ketë mundësinë të shohë avantazhet e punës në bashkëpunim. Fillimisht, një i rritur duhet të mbikëqyrë dhe të orientojë fëmijët, nëse është e nevojshme, por i rrituri gradualisht duhet të tërhiqet në mënyrë që fëmijët të veprojnë të pavarur.

RASTI STUDIMOR 25

Një fëmijë që përdor shumë dhunë në lojë

Billi është një fëmijë i vetmuar dhe në parashkollë zakonisht luan vetëm. Ndonjëherë ai arrin të përfshihet me fëmijët e tjerë por bashkohet në aktivitetet e tyre pa ia kërkuar njeri dhe pak a shumë u imponohet atyre. Ai ka qejf të luajë me shtëpinë e kukullave apo në këndin e shtëpisë. Personeli ka vënë re që ai i përdor kukullat për të luajtur skena që kanë shumë dhunë. Kukullat hedhin gjëra përreth shtëpisë dhe përmbysin mobiljet. Billi bën një koment të vazhdueshëm teksa luan dhe përdor të bërtiturat për të ilustruar konfrontimet midis kukullave. Ai luan të njëjtën lojë në shumicën e kohës në parashkollë dhe, kur persona të personelit mundohen të flasin me të, ai përgjigjet shkurt dhe largohet të luajë me diçka tjetër. Kur Billi luan me kukullat në këndin e shtëpisë, është vënë re se ai është shumë i ashpër me to dhe i qëllon rregullisht.

Arsyet e mundshme për këtë sjellje

Billi:

- shikon shumë televizion dhe riprodhon ato që sheh
- ka aftësi loje të kufizuara prandaj përsërit gjithnjë të njëjtën lojë. Kjo mund të reflektojë një vonesë të përgjithshme të aftësisë njohëse
- mund të jetë duke kopjuar sjelljet e të rriturve që jetojnë me të
- ndoshta po mundohet t'u japë kuptim gjërave që ka parë duke i riprodhuar ato në shtëpinë e kukullave

Strategjitë:

- Kontrolloni aktivitetet e Billit nga afër dhe mbani shënime të të gjitha fakteve
- Mund të ekzistojnë çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës – sigurohuni që të gjithë në personel i njohin procedurat për të tilla raste
- Sigurohuni që Billi të përfshihet në një gamë të gjerë aktivitetesh nëse personeli mendon se ai ka aftësi të kufizuara të të luajturit. Burimet duhen planifikuar me shumë kujdes duke marrë parasysh kushtet specifike të Billit
- Monitoroni nga afër ecurinë e përgjithshme të Billit në kuadrin e kurrikulës
- Diskutojini këto shqetësime me prindërit/kujdestarët e Billit.

KAPITULLI

3

Aftësitë për të luajtur

Zhvillimi i aftësive për të luajtur

Zhvillimi i lojës me imagjinatë

Loja pozitive – një program për fëmijët me aftësi të pakta sociale



Zhvillimi i aftësive për të luajtur

Fëmijët kanë nevojë të zhvillojnë një gamë aftësish për të përdorur eksperiencat e lojës në maksimum. Kjo mund të konsiderohet në gjashtë fusha dhe përgjithësisht, nevojitet të arrihet një zhvillim i balancuar në secilën prej tyre. Gjashtë fushat janë:

- **Fusha shoqërore** – ku fëmija shfaq interes për njerëzit e tjerë dhe fillon të zhvillojë ndjeshmërinë për të tjerët
- **Komunikimi** – ku fëmija dëshiron të komunikojë nëpërmjet komunikimit verbal dhe jo-verbal
- **Aftësitë motorike të vogla** – ku fëmija zhvillon koordinimet e vogla motorike dhe shkathhtësinë
- **Aftësitë motorike të mëdha** – që lidhen me lëvizshmërinë dhe qëndrimin e trupit
- **Aftësitë e të menduarit dhe imagjinatës** – të nevojshme për lojërat me simulim
- **Vëmendja** – ku fëmija zhvillon përqendrimin dhe vëmendjen e fokusuar

Mund të jetë shumë e dobishme të përdoren tabelat e mëposhtme si një listë kontrolli për të vlerësuar pikat e forta të fëmijëve si dhe fushat në të cilat ata mund të kenë nevojë për mbështetje në mosha dhe faza të ndryshme

Fazat e zhvillimit për aftësitë shoqërore dhe të komunikimit		
Mosha mesatare	Aftësitë shoqërore	Aftësitë e komunikimit
0 – 6 muajshe	Fëmija zhvillon ndjenjat e sigurisë dhe besimit nëse i ofrohen metoda të rregullta	Fëmijës i pëlqen të shohë fytyra dhe fillon të përdorë shprehjet e fytyrës. I pëlqejnë tingujt qetësues.
6 – 18 muajshe	Fëmija fillon të njohë vetveten si një person i veçantë. Fillon të dallojë që disa veprime prodhojnë pasoja. I pëlqejnë vjershat e përsëritura si dhe të parashikojë veprimet.	Fëmija fillon të belbëzojë. Arrin të imitojë tinguj dhe gjeeste. Shpesh lëshon tinguj edhe vetë.
18 muajshe– 3-vjeçare	Loja paralele. Do të luajë përkrah fëmijëve të tjerë. Mund të fillojë lojën me të rriturit duke i çuar një të rrituri ndonjë lodër. Mund të drejtohet tek aktivitetet nga një i rritur dhe të marrë pjesë në to.	Bashkohet në recitime vjershash dhe këngë me veprime. I pëlqen përsëritja e përrallave. Di të thotë emrat e figurave dhe të nxjerrë tinguj duke imituar, p.sh. kafshët. Mund të flasë për veprimet.
3 – 4-vjeçare	Bashkohet me grupe. Merr inisiativën të krijojë kontakte me fëmijët e tjerë dhe luan me të tjerët.	Di fjalët e këngëve dhe vjershave dhe mund të këndojë pa ndihmë. Mund të bisedojë për një objekt apo ngjarje edhe nëse nuk ndodhet atje.
4 – 5-vjeçare	Lojë në bashkëpunim – mund të luajë duke ndjekur rregullat dhe mund të hartojë rregulla edhe vetë.	Komunikim reciprok dhe bashkëbisedim. Di të mbajë radhën kur bashkëbisedohet.



Fazat e zhvillimit për aftësitë shoqërore dhe të komunikimit

Mosha mesatare	Aftësitë motorike të vogla	Aftësitë motorike të mëdha
0 – 6 muajshe	Rrotullon kokën dhe duart duke ndjekur muzikën ose lëvizjet. I pëlqejnë pëlçitjet dhe lodrat lëvizëse	Zhvillon kontrollin e kokës. Kthen kokën në drejtimin e zhurmave ose lëvizjeve. Mundet të rrijë ulur.
6 – 18 muajshe	Eksploron duke përdorur gojën. Është i interesuar për ambientin dhe eksploron atë. Krijon tinguj duke përplasur objekte	Mund të ulet pa ndihmë. Mund të rrijë në këmbë dhe të lëvizë përreth mobiljeve. Ka lëvizshmëri të pavarur.
18 muajshe– 3-vjeçare	Mund të luajë lojën "Tah". I pëlqejnë lodrat me shkak dhe pasojë. Fillon të njohë sendet që janë të njëjta dhe t'i klasifikojë ato. I pëlqen të luajë me rërë dhe ujë.	Preferon të luajë përjashta ose në dyshe. Përfiton nga një karrige ndihmëse me krahë afër tavolinës për t'u përfshirë në kohën e ngrënies dhe aktiviteteve. Thasët me fasule mund të ndihmojnë
3 – 4-vjeçare	I pëlqejnë aspektet krijuese p.sh. gatimi, plastelina dhe ngjithësat. Mund të bëjë figura me copa	Lojë aktive – i pëlqejnë shkallët paralele dhe pajisjet si dhe lodrat me pedale/që shtyhen/të cilave mund t'u hipësh. Nëse përpigjen të inkurajoni aktivitete në grup në kohën e rrethit, një thes fasulesh mund të hyjë në punë
4 – 5-vjeçare	Mund të ndërtojë me lloje të ndryshme pajisjesh ndërtimi çka përfshin aftësitë e vogla motorike	I pëlqejnë aktivitetet e zhvilluara përtokë. Aktivizohet më mirë i ndihmuar nga një karrige ndihmëse me mbështetëse për aktivitetet në tavolinë

Fazat e zhvillimit për aftësitë shoqërore dhe të komunikimit

Mosha mesatare	Loja me simulim	Vëmendja tek detyrat
0 – 6 muajshe	Reagon ndaj zhurmave dhe lëvizjeve që sheh	Reagon ndaj tingujve të rinj ose stimulit të lëvizjeve
6 – 18 muajshe	Nxit veprimet e të tjerëve. I përsërit ato edhe vetë, p.sh. ushqen arushin.	Preferon zgjedhjen e vet për aktivitetet dhe mund të përfshihet totalisht. Mund të ketë vështirësi në ndjekjen e aktiviteteve të udhëhequra nga të rriturit
18 muajshe– 3-vjeçare	Përdor arushat dhe kukullat për të realizuar veprimet. Janë të dukshme në lojë sendet "simuluese", p.sh. përgatitja e çajit dhe filxhani për të pirë duke përdorur filxhanë lodre	Është i aftë të ndjekë aktivitetet të udhëhequra nga të rriturit. Ka nevojë për prezencën e të rriturve për të ruajtur përqendrimin. Fokusetohet në një aspekt të vetëm gjatë një kohe të caktuar dhe mund të përfshihet totalisht. Ndryshimi i objektit të vëmendjes mund të kërkojë udhëheqjen e një të rrituri.
3 – 4-vjeçare	Mund të përdorë lodra dhe sende për të vënë në skenë ngjarje të ndodhura gjatë kohëve të fundit. Përfshihet totalisht në lojën imituese siç është këndi i shtëpisë, bërja e pazarit etj.	Nuk shpërqendrohet më aq lehtësisht nga detyrat e drejtuara nga të rriturit. Mund ta zhvendosë vëmendjen nga një aktivitet në tjetrin. Ka nevojë të ndalojë aktivitetin për të dëgjuar udhëzimet.
4 – 5-vjeçare	Përdor imagjinatën e tij për lojërat me role, si p.sh. shtojzovallat, bajlozët etj.	Mund të kryejë një detyrë dhe të dëgjojë udhëzimet në të njëjtën kohë

Zhvillimi i lojës me imagjinatë

Kjo është një fushë që kërkon vëzhgim nga afër sepse mund të na japë informacion të një cilësie të lartë rreth fëmijës. Në fazat e hershme të lojës, fëmijët imitojnë veprimet e të tjerëve, veçanërisht nëse inkurajohen që ta bëjnë këtë. Duke ndjekur këtë fazë duhet të kihet parasysh dy stadi kryesore:

Stadi 1 në të cilin fëmija përdor sendet reale si simbole dhe objekte skenike. Ky është një nivel konkret i lojës dhe mund të përfshijë eksperiencën vetëm dhe me të tjerë.

Shembuj të këtij stadi janë:

- ushqimi i kukullës apo arushit duke përdorur një shishe lodre
- bërja e drekës duke përdorur pjatë dhe ushqim plastik
- shëtitja e arushit në karrocë
- përgatitja e një liste të rreme pazari duke përdorur letër dhe laps
- shtyrja e makinave prej lodre përgjatë një trajektoreje

Stadi 2 në të cilin zhvillohet një nivel më abstrakt i lojës

Ka dy lloj shembujsh për këtë stad:

1. Fëmija hyn në situata imagjinare pa pasur lodra apo sende, si:

- bën një gotë çaji duke përdorur vetëm veprimet
- bën sikur ndodhet në një makinë dhe i jep asaj
- bën dhe ha një kek imagjinar
- largohet me vrap për t'i shpëtuar një bajlozi imagjinar apo ndonjë përbindëshi tjetër
- hap një derë dhe hyn brenda duke përdorur vetëm veprimet

2. Fëmija u jep sendeve ose njerëzve funksione të tjera, si p.sh.:

- një arush, kukull apo fëmijë tjetër mund të bëhet bebjë ose prindi
- kur luajnë dyqanesh, mund të bëhen shitës ose blerës
- kur luajnë spitalësh, mund të bëhen doktorë ose infermierë
- mund të bëhen zjarrfikës, policë ose engjëj duke përdorur kostumet që ka kopshti
- duke përdorur kukullat ose lodrat, mund të shndërrohen në personazhe të tjerë

Shumica e fëmijëve i kalojnë këto stadi në mënyrë natyrale. Por disa fëmijë kanë nevojë për mbështetje në zhvillimin e lojërave të Stadit 2.

Nëse një fëmijë duket se ka ngelur në Stadin 1, ai mund të ketë nevojë për një demonstrim të aktiviteteve të Stadit 2 në mënyrë që të mund t'i kopjojë ato si fillim dhe më pas të marrë pjesë në lojërat. Do të jetë gjithashtu e rëndësishme të vërehet nëse fëmija në Stadin 1 është i përfshirë kryesisht ose vetëm në lojëra që luhen vetëm apo është i aftë të bashkohet në aktivitete me fëmijët e tjerë.

Një vëzhgim nga afër i lojërave simuluese mund të vjelë informacione shumë interesante. Disa fëmijë duken totalisht të thithur në aktivitetet e tyre por, kur vëzhgohen më me kujdes, ata thjesht janë duke vënë makinat dhe trenat në radhë ose duke mbushur dhe zbrazur lavatriçen në këndin e shtëpisë. Ky lloj vëzhgimi është veçanërisht i rëndësishëm për t'u përdorur si informacion për fëmijët që duket se kanë vështirësi në fushat e komunikimit shoqëror ose mund të kenë vështirësi emocionale. Disa nga këta fëmijë mund të mos jenë gati për t'u përfshirë në disa nga aktivitetet dhe, edhe pse mund të inkurajohen që të imitojnë, ata mund të mos jenë në gjendje t'i përdorin këto aftësi





me forcat e tyre. Mund të nevojiten këshilla të mëtejshme nga Specialisti i Zonës për Koordinimin e Nevojave të Edukimit (SENCO) ose nga një psikolog edukimi mbi mënyrën më të mirë për t'i mbështetur këta fëmijë.

Loja pozitive – një program për fëmijët me aftësi të pakta sociale

Shumica e fëmijëve përshtaten shumë mirë në ambientet e fëmijërisë së hershme – disave u duhet pak më shumë kohë dhe mund të kalojnë një fazë gjatë së cilës janë shumë të turpshëm apo qajnë shpesh, ndërsa të tjerët kërcejnë në dhomë me besim në vetvete që ditën e parë. Ky fakt varet shumë nga eksperiencat e tyre përpara se të hynin në çerdhen apo kopshtin tuaj. Nëse ata kanë patur që më parë eksperiencë loje me fëmijët e tjerë, kanë qenë në shtëpitë e njerëzve të tjerë, kanë dalë në park dhe kanë zbuluar kënaqësinë dhe grackën e shilarësve e rrëshqitësve dhe kanë mësuar se si të përshtaten me ndarjen e lodrave me vëllezërit dhe motrat, atëherë këta fëmijë ndoshta do të përshtaten shumë mirë me shumicën e situatave të parashkollës.

Megjithatë, herë pas here ka fëmijë që regjistrohen në çerdhen/kopshtin tuaj dhe duket se nuk arrijnë të kuptojnë rregullat dhe rutinat si të tjerët. Ndonjëherë fëmijët tërhiqen brenda vetes ose bëhen qaramanë dhe kanë nevojë për shumë lajka dhe punë bindëse që të bashkohen me të tjerët. Ata mund të hezitojnë edhe të hyjnë në dhomë apo të dalin jashtë në oborr. Këta fëmijë kanë nevojë të trajtohen në një mënyrë delikate dhe t'u lejohej të kalojnë kohë thjesht duke ndenjur e duke vëzhguar se çfarë ndodh. Në të shumtën e rasteve, këta fëmijë të ndrojtur janë të aftë që t'i kapërcejnë kufizimet që kanë nëse u jepet një shans.

Individë të tjerë mund të sillen në mënyrë shumë të egër apo edhe agresive, duke rrëmbyer lodrat dhe duke hedhur rërë, duke thirrur dhe duke përzënë të tjerët nga hapësira 'e tyre' dhe duke kundërshtuar të gjitha përpjekjet që bëhen për t'ua zhvendosur atyre vëmendjen nga të shkaktuarit e shamatave përreth. Ky mund të jetë një problem i madh veçanërisht në hapësirat përjashta ku është më e vështirë për të rriturit që të kontrollojnë nga afër gjithçka që ndodh. Fëmijët mund të kenë vështirësi në hapësirat përjashta për shumë arsye. Këto arsye mund të përfshijnë edhe mungesën e eksperiencës, sasinë e madhe të aktiviteteve të ofruara që atyre mund t'u duket mbingarkuese, vështirësitë për të kuptuar se çfarë pritet prej tyre ose ndoshta vështirësitë e lidhura me çrregullimet e spektrit autist (ASD). Cilado qoftë arsyeja, nëse kjo lloj sjelljeje vazhdon, dhe veçanërisht nëse këta fëmijë janë gati për të hyrë në sistemin e përgjithshëm shkollor, do të ishte e dobishme përgatitja e një programi të planifikuar ndërhyrjeje për të adresuar këto probleme. Një program aktivitetesh me të gjitha hollësitë dhe elementet kohore, që vë në shënjestër aftësitë specifike dhe organizohet në bazë ditore dhe javore për një numër të caktuar javësh, mund ta ndihmojë fëmijën të zhvillojë aftësitë e duhura për të kaluar një kohë të këndshme dhe të suksesshme. Një program i tillë do të ofrojë gjithashtu informacion shumë të vlefshëm mbi nevojat e fëmijës i cili mund t'i kalohet shkollës. Loja Pozitive është një nga programet e testuara dhe provuara nga vetë ne.





Përgatitja e programit

Kur punoni me fëmijë shumë të vegjël të cilët po kalojnë vështirësi, metoda “pak dhe shpesh” është zakonisht më e mira. Gjithashtu, është esenciale që të gjithë ata që janë në kontakt me fëmijën të përfshihen totalisht në program. Kjo do të fillojë me takimin me prindërit/kujdestarët për t’i angazhuar ata me programin. Një mbledhje miqësore por profesionale duhet organizuar për t’u shpjeguar familjarëve shqetësimet tuaja mbi nevojat e fëmijës dhe për të diskutuar ndërhyrjet që ju propozoni. Ata duhet të ftohen që të ofrojnë ide për të mbështetur programin në shtëpi. Këto lloj intervistash mund të jenë të vështira sepse shumica e prindërve thjesht shpresojnë që fëmijës së tyre do t’i kalojë kjo faza e të shtyrave dhe rrëmbimit të lodrave duke u rritur. Prandaj është shumë e rëndësishme që prindërit/kujdestarët të mbahen të informuar për të gjitha hollësitë e ecursisë së fëmijës së tyre. Kjo duhet të fillojë që nga futja e fëmijës në parashkollën tuaj në mënyrë që ata të mos befasohen nga fakti që fëmija i tyre ka nevojë për mbështetje ekstra. Nëse është e përshtatshme, prindërve mund t’u jepet një tabelë e thjeshtë për të ngjitur yjet të cilën mund ta vënë tek dera e frigoriferit për të inkurajuar sjellje të mirë dhe bashkëvepruese edhe në shtëpi. Në këtë mbledhje fillestare është e rëndësishme të vendoset një datë për rishikimin e ecursisë së fëmijës në fund të programit gjashtëjavor. Fëmija mund të ketë bërë përmirësime të konsiderueshme gjatë gjysmës së semestrit, por këto mbledhje rishikuese mund të përdoren për të diskutuar ndonjë ndërhyrje të mëtejshme e cila mund të jetë e nevojshme.

Gjatë ndërtimit të programit do të ndihmojë shumë realizimi paraprak i një vëzhgimi formal të fëmijës duke përdorur një tabelë vëzhgimi të ngjashme me atë të ofruar në Shtojcën 1. Këto vëzhgime, të realizuara për 10 deri në 15 minuta çdo herë, në pjesë të ndryshme të orës së mësimi dhe të lojës, mund të ndihmojnë për të treguar se në ç’fusha ndodhin problemet. Gjithashtu, do të ndihmojë për të identifikuar fëmijë të tjerë që mund të përfitojnë nga përfshirja në këtë program ose ata fëmijë që mund të përfshihen si modele të mira sjelljeje.

Duhet identifikuar si i rrituri kryesor apo shpërndarësi i programit një anëtar i personelit me eksperiencë. Këtij personi duhet t’i lihet, për të paktën 45 minuta çdo javë, për të gjashta javët e programit, përgjegjësia e drejtimit të tij dhe e sigurimit të vazhdimësisë në përgjithësi dhe në bazë ditore. Shumë shpesh një fëmijë do të sillet mirë gjatë orëve të strukturuar 45 minutëshe të mësimi por do ta ketë të vështirë t’i përmbahet mbajtjes së radhës apo të folurës me edukatë gjatë momenteve të tjera të javës. Është e rëndësishme që i gjithë personeli të jetë informuar mbi çfarë po implementohet në mënyrë që edhe ata të jenë në gjendje ta përforcojnë programin në orë të tjera të ditës. Do të ishte vërtet shkatërruese për suksesin e këtij programi nëse, për shembull, objektivi i kësaj jave do të ishte i fokusuar në përdorimin e përbashkët të lodrave por, në mënyrë të pavëmendshme, një anëtar i personelit do të rrinte indiferent kur fëmija do të rrëmbente lodrat dhe do të shtynte fëmijët e tjerë pa i rikujtuar atij rregullin që ‘ne i ndajmë lodrat me të gjithë’.

Objektivat tipike për të adresuar sjelljet e ndryshme të fëmijës gjatë programit mund të përfshijnë:

- të lejojë që një fëmijë tjetër të luajë përkrah me të (pa e shtyrë)
- të luajë pa rrezikuar në oborrin e kopshtit
- të presë radhën, për shembull për të marrë lopatën (me një të rritur)
- të presë radhën për përdorimin e pajisjeve (me një fëmijë tjetër)
- të kthehet brenda sapo t’i kërkohet



- të përdorë tonin e duhur të zërit për jashtë dhe për brenda
- të ulet qetësisht gjatë kohës së zemrës
- të lërë të tjerët të dëgjojnë një tregim (pa thirrur)

Kur vendosen objektivat, është e rëndësishme që ato të jenë sa më specifike që të jetë e mundur. Të luajturit “pa sherr” është shumë i përgjithshëm për t’u matur. Ndarja e një lodre për një periudhë kohe të caktuar (nga një minutë çdo herë deri në, le të themi, dhjetë minuta) do të ishte shumë më e dobishme si provë e ecures së fëmijës. Do të jetë e nevojshme të mbahen shënime të thjeshta për ecurinë të cilat do të ofrojnë prova lidhur me cilat pika të programit kanë qenë më shumë dhe më pak të suksesshme. Çdo fëmijë është një individ, por ndjekja e një sërë aktivitete bazë gjatë programit do ta bëjë më të lehtë ofrimin e ndërhyrjeve të ngjashme për fëmijë të tjerë në të ardhmen.

Mbasi të jenë realizuar intervistat me prindërit, informimi i personelit dhe përcaktimi i objektivave, mund të fillojë implementimi i programit. Të gjitha ambientet e fëmijërisë së hershme janë të ndryshme, por një shembull plani është dhënë më poshtë.

Shembull programi

Java e Parë

Çdo orë, i rrituri kryesor e merr fëmijën për dore dhe e drejton në zonën e aktivitetit të përzgjedhur, duke mbledhur dy ose tre fëmijët e tjerë që do të jenë bashkë me të në këtë aktivitet dhe, në të njëjtën kohë, duke shpjeguar që “ne luajmë pa u vlarë” në kopshtin tonë dhe duke i treguar fëmijës se çfarë do të ndodhë më pas, p.sh. “Sot ne do të luajmë me rërë sëbashku me Xhoin dhe Anin”. Shpjegojini qartë sjelljen që ju prisni prej tij: “Unë dua që ti të luash pa rrezikuar dhe ta mbash rërën në tabaka – pastaj mund të vazhdosh me lojën tënde të preferuar...”. Duke pasur një listë aktivitete të paravendosura të cilat janë diskutuar më parë me prindërit dhe të gjithë të rriturit e tjerë të përfshirë, është e mundur që të gjithë të diskutojnë me fëmijën, që në fillim të ditës, se çfarë do të ndodhë. Një matës kohe i madh mund të jetë i dobishëm për të ndihmuar fëmijët të fokusohen (p.sh. “Kur e gjithë rëra të ketë rënë poshtë, *atëherë* mund të shkojmë në aktivitetin tjetër.”).

Mbasi fëmija të ketë luajtur pa rrezikuar për numrin e minutave të paracaktuar (dhe ky numër mund të ndryshojë nga një fëmijë tek tjetri – disa mund të jenë të paaftë të menaxhojnë më shumë se rreth dy minuta çdo herë), ai duhet të ftohet që t’i marrë dorën të rriturit dhe të zhvendoset pa zhurmë në aktivitetin tjetër. Disa fëmijëve mund t’u vijë në ndihmë të merren përdore dhe të bëjnë një shëtitje përreth oborrit teksa i rrituri u tregon me gisht shembuj të të luajturit të lumtur dhe në bashkëpunim, p.sh. “Shikoji Xhonin dhe Ahmedin – ata po kënaqen duke luajtur sëbashku me motoçikletën dhe secili ka radhën e vet”.

Është e rëndësishme që çdo seancë e programit të ndjekë të njëjtin model në mënyrë që të vendoset një rutinë që nga fillimi:

1. Rikujtimi i rregullave përpara se të fillojë aktiviteti (p.sh. ne luajmë pa u vlarë dhe asnjëherë nuk i qëllojmë të tjerët)
2. Aktivitete të shkurtra me të rriturin kryesor dhe dy apo tre fëmijë të tjerë, duke inkurajuar diskutime rreth lojës pa dëmtime dhe duke i përdorur lavdërimet si duhet: “Më pëlqen shumë se si ti po pret që Ani të mbushë kovën e saj...”
3. Nëse është e nevojshme, një shëtitje përreth zonës dhe një bisedë rreth aktivitetit duke i treguar me gisht shembuj të sjelljeve të mira të fëmijëve të tjerë

4. Një aktivitet të dytë në të cilin fëmijës do t'i duhet të ndajë pajisjet dhe të presë radhën e tij. Shpesh është një ide e mirë që, për ta bërë këtë lojë më efektive, të siguroheni që pajisjet nuk janë të mjaftueshme që çdo fëmijë të mund të ketë të vetën, në mënyrë që ata të detyrohen të praktikojnë të kërkuarin, sigurimin e pajisjeve për njëri-tjetrin, dhe të mësohen që të ndajnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.
5. Një këngë apo vjershë në grup për të mbyllur orën
6. Kthim në zonën kryesore të aktiviteteve

Ambientet e fëmijërisë së hershme variojnë shumë nga njëri-tjetri por të gjithë kanë një pushim apo kohë për ushqim. Do të jetë pozitive për fëmijën që punonjësi kryesor të ulet me të dhe të bisedojë edhe mbi 'rregullat' e kohës së pushimit.

Java e Dytë

Gjatë javës së dytë të programit, i rrituri kryesor mund të dojë të prezantojë një fëmijë tjetër në program për të luajtur përkrah fëmijës që është në objektin, duke u siguruar që ata i dinë emrat e njëri-tjetrit. Fëmijët që kanë paraqitur vështirësi në lojën në bashkëpunim me të tjerët shpesh duket se kanë probleme për të mësuar emrat e fëmijëve të tjerë dhe mund të jetë një ndihmë për zhvillimin e aftësive të tyre shoqërore nëse ata inkurajohen që t'i drejtohen njëri-tjetrit me emër (në vend që thjesht ta prekin njëri-tjetrin me dorë për t'i tërhequr vëmendjen). Edhe pse qëllimi i javës është inkurajimi i fëmijëve për të luajtur dhe për të folur në mënyrë bashkëpunuese përkrah njëri-tjetrit, në fillim të javës i rrituri duhet të rrijë afër ose ndërmjet fëmijëve për të zbutur ndonjë mosmarrëveshje dhe për të mos i lënë të inatosen. Format i programit në Javën e Dytë ngelet i njëjtë me atë të Javës së Parë, duke përdorur çdo aktivitet që ofrohet atë javë. Me më shumë fëmijë që luajnë sëbashku bashkëbisedimet dhe përdorimi i fjalorit do të rriten. Megjithatë i rrituri duhet të sigurohet që fjalë të tilla si “i barabartë”, “ndarje”, “i mirë”, “radha”, “pa rrezik” etj. prezantohen në mënyrë të dukshme. Në ambientet e fëmijërisë së hershme, katër fëmijë në grup është mbase idealja por, në varësi të nivelit të aftësive shoqërore të fëmijëve, mund të jetë e mundur që të keni gjashtë fëmijë që punojnë përkrah njëri-tjetrit.

Java e Tretë

Nëse të gjithë fëmijët kaluan mirë me njëri-tjetrin përgjatë javës së dytë dhe të gjithë duket se përfituan nga loja sëbashku, do të ishte një ide e mirë që të mbahej i njëjti grup fëmijësh përgjatë gjithë programit. Por, në të kundërt, nëse i rrituri ndjen se përfshirja e një fëmije tjetër që mund t'i shtohet grupit ose të zëvendësojë njërin nga shokët mund të jetë një ide e mirë, atëherë ky është momenti më i përshtatshëm për ta bërë këtë ndryshim.

Nga fundi i Javës së Tretë mund të bëhet shumë e qartë nëse ky ndryshim ka sjellë ndonjë efekt. Një vëzhgim i shkurtër dhe formal duke përdorur të njëjtën tabelë si më parë mund të ndihmojë për të parë nëse janë realizuar përmirësime të rëndësishme apo ka një mungesë të tyre totale. Nëse ka pasur përmirësime të vërteta, atëherë mund të vazhdohet me pjesën e dytë të programit. Megjithatë, nëse duket që fëmija ka akoma vështirësi të theksuara edhe në shoqërimin vetëm me një fëmijë tjetër, atëherë të gjithë të rriturit duhet të mblidhen për të diskutuar se cila do të jetë mënyra më e mirë për të ecur përpara. Vendosja e një të rrituri për të punuar përkrah fëmijës mund të ketë sjellë gjithashtu identifikimin e të tjera vështirësive që disa fëmijë mund të jenë duke kaluar. Mund të dalin



në pah probleme me emrat e ngjyrave, një koordinim i dobët i syve dhe duarve ose vështirësi me gjuhën shprehëse dhe perceptuese. Përsëritja e Javës së Parë, të Dytë dhe të Tretë mund të jetë mënyra më e mundshme për të vazhduar programin.

Java e Katërt

Disa herë nuk është e mundur të mbahet i njëjti person nga personeli që të punojë gjatë gjithë programit çdo javë. Nëse persona të ndryshëm do të përfshihen për të drejtuar programin, kjo mund të ndihmojë duke na pajisur me të dhëna të vlefshme mbi nivelin e adaptimit të fëmijës me ndryshimet. Përgjatë Javës së Katërt një ndryshim *i planifikuar* i të rriturit kryesor mund të përfshihet në program dhe mund të mbahen shënime mbi aftësinë e fëmijës për të përballuar këtë ndryshim.

Java e Katërt është koha në të cilën i rrituri duhet të tërhiqet paksa nga të qenët pjesë e grupit dhe t’u lejojë fëmijëve të gjenerojnë bisedat e tyre duke i dhënë atij mundësinë të bëjë disa vëzhgime dhe të shohë se si po zhvillohen ndërveprimet shoqërore. I rrituri megjithatë duhet të qëndrojë pranë, në mënyrë që të ketë mundësi të ndërhyjë dhe t’u kujtojë fëmijëve rregullat, t’i mbajë ata të fokusuar tek detyrat dhe të eliminojë çdo mundësi për zënka apo mërzitje që mund vijë nga bashkëbisedimet e fëmijëve. Fjalët më shpesh të përdorura duhet të jenë akoma “pa rrezik”, “ndarje”, “radha”, “shoku”, “i mirë” etj. Kur i rrituri përzgjedh aktivitetet, është e nevojshme që të sigurohet që, të paktën për një pjesë të kohës, fëmijët të mos kenë lodra të mjaftueshme për secilin, në mënyrë që të detyrohen të gjejnë një marrëveshje për ndarjen e lodrave ndërmjet tyre, pa pasur domosdoshmërisht të rriturin që ta bëjë këtë për ta. Aftësia për të bërë marrëveshje dhe koncepti i barazisë dhe drejtësisë do të jenë të rëndësishme për ta kur të kalojnë në shkollën e përgjithshme ku ka më pak të rritur përreth që ‘i zgjidhin gjërat’. Kjo nuk është e lehtë për shumë fëmijë dhe i rrituri mund të diskutojë me ta mundësinë: “Çfarë do të ndodhte nëse ...?” përpara se të dalin në oborr. Matësi i madh i kohës prej rëre mund të ndihmojë shumë kur diskutohet ‘barazia’ dhe ‘radha’.

Formula bazë e programit në Javën e Katërt mbetet e njëjta por përfshin aktivitete më ambicioze të tilla si bërja e kekut ose kremosja e biskotave për t’i ndarë me të tjerët në parashkollë. Edhe detyra si organizimi i ndarjes së lëngjeve dhe biskotave për të gjithë parashkollën ose dhënia e ndihmës për të hequr rrëmujat mund të ndërmerren, të mbikëqyrura nga afër prej të rriturit kryesor.

Java e Pestë

Në javën e Pestë, nëse fëmijët janë duke bashkëpunuar mirë dhe i janë përgjigjur siç duhet programit i cili thekson të priturit e radhës dhe të dëgjuarit e të tjerëve, të rriturit mund të dëshirojnë që të prezantojnë lojëra më të komplikuar dhe konkurruese. Për shembull një ‘mos u nxeh’ në përmasa gjigande ose aktivitete si “Rrethi i miqve dhe familjes” (shikoni faqen 51) mund të gjenerojnë shumë diskutime dhe ndarje informacioni. Fëmijët që kanë vështirësi me vizatimin (p.sh. ata me vështirësi motorike të vogla të cilët nuk mundën të mbajnë lapëstilin apo lapsat) mund të preferojnë që të përdorin kutinë me kopsa për të kompletuar rrathët. Mund të jetë interesante të vëzhgohet se cilat kopsa përzgjidhen për të përfaqësuar njerëz të ndryshëm. Përdorimi i aktivitetit të “shkallëve paralele të arushave” është një mënyrë tjetër për t’i inkurajuar fëmijët që të ndajnë mendimet dhe të dëgjojnë të tjerët (shikoni faqen 52). Edhe nëse në dukje disa nga fëmijët mund të jenë duke e përdorur këtë aktivitet ‘vetëm për të ngjyrosur arushat’, aftësitë për të ndarë lapëstilat, për t’i lejuar të tjerët të thonë mendimin e tyre dhe për të komentuar mbi eksperiencat e tyre në ngjitjen e shkallëve paralele janë të rëndësishme, kështu që i rrituri nuk ka përse ta ndjejë të





nevojshme të bëjë pyetje hetuese apo të insistojë që fëmijët të shprehin mendimin e tyre.

Gjatë Javës së Pestë është e rëndësishme që i rrituri të përgatisë grupin për seancën e ardhshme dhe të fundit. Çdo fëmijë i kërkohet të përzgjedhë një fëmijë tjetër nga parashkolla dhe ta ftojë atë të bashkohet me grupin e tij për pije dhe biskota ose fruta gjatë javës së gjashtë. Shumica e fëmijëve nuk para ftojnë më shokë në shtëpi dhe kanë pak eksperiencë në të ftuar dhe në pranimin e ftesave. Në parashkollë kjo mund të realizohet duke i dhënë fëmijës mundësinë që t'i dërgojë një ftesë shokut të përzgjedhur. Fëmijët duhet të inkurajohen që të mendojnë me kujdes se cilin duan të ftojnë – mund të jetë një fëmijë që është i ri në parashkollë dhe ka nevojë të ndihmohet për t'u adaptuar, mund të jetë dikush që shpesh nuk ka me kë të luajë ose mund të jetë dikush me të cilin kanë luajtur shumë herë më parë. Është gjithashtu e dobishme që edhe i rrituri të ftojë një të rritur tjetër për koktejin. Nëse është e rastit, mund t'u kërkohet prindërve/ kujdestarëve të fëmijëve të grupit që të dërgojnë një kontribut, si një kuti biskotash, disa fruta etj.

Java e Gjashtë

Në javën e gjashtë aktiviteti i parë duhet të jetë që fëmijët vetë të organizohen midis tyre dhe të rregullojnë pijet dhe ushqimet në një mënyrë të prezantueshme si dhe të sigurohen që kanë karrike, pjata dhe gota të mjaftueshme për të gjithë të ftuarit. Pajisja me disa letra të bardha për t'u ngjyrosur dhe për t'u bërë si mbulesa tavoline është një mënyrë e mirë për ta mbajtur grupin të zënë me punë dhe i jep të rriturit shansin që të shpjegojë se ata do të kujdesen për të ftuarit e tyre dhe do të sigurohen që ata të kenë lëng dhe diçka për të ngrënë. Të ftuarit nuk është e nevojshme që të rrinë shumë gjatë pasi ky nuk është rasti për të bërë një festë të madhe. Fëmijët kanë thjesht nevojë të praktikojnë mirësjelljen dhe aftësitë e tyre të bashkëndarjes dhe të të dëgjuarit. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që fëmijët vetë të pastrojnë mbas koktejit.

Gjithashtu është e dobishme për të rriturin që të informojë prindërit mbi çdo sukses dhe progres që ka arritur fëmija i tyre gjatë programit dhe t'u japë edhe atyre mundësinë të japin informacion mbi çdo përmirësim në aftësitë shoqërizuese të fëmijës që ata kanë vënë re në mjedisin e shtëpisë. Mbajtja e shënimeve mbi strategjitë apo lojërat që kanë qenë më të suksesshme në zhvillimin e aftësive shoqërore të fëmijëve do të vijë në ndihmë nëse parashkolla vendos ta ripërdorë këtë program me ndërhyrje të ngjashme në të ardhmen dhe komentet e prindërve mund të ndihmojnë në vlerësimin e punës së këtij grupi të vogël.




Rrethi i miqve dhe familjes – shpjegimi

I rrituri u kërkon fëmijëve të vizatojnë veten e tyre në rrethin e mesit dhe njerëzit që janë më afër tyre (d.m.th. ata që jetojnë me ta) në rrethin e dytë. Në rrethin e tretë fëmija vizaton njerëz që ai i sheh në më të shumtën e ditëve (këta mund të jenë komshinjtë, kushërinjtë, shokët dhe personeli i parashkollës etj.). Fëmijët vizatojnë njerëzit që ata shohin ndonjëherë në rrethin tjetër (p.sh. doktorin, shitësen, postierin). Një rreth i fundit në pjesën e jashtme mund të shtohet që fëmijët të vizatojnë njerëzit që ata shohin rrallë (p.sh. kushërinjtë që jetojnë jashtë). Fëmijëve që kanë vështirësi me vizatimin mund t’u jepet një kavanoz me kopsa që ata të përfaqësojnë vetveten, familjen dhe shokët e tyre.

Shikoni Shtojcën 2 për një format bosh

Ky aktivitet mund të gjenerojë shumë diskutime dhe ndarje informacioni.

Rrethi i miqve dhe familjes – shembull





Aktiviteti i shkallëve paralele të arushave - shpjegim

Ky është një aktivitet për të inkurajuar diskutimet rreth ndjenjave dhe për të praktikuar të dëgjuarin e të tjerëve. Kjo mund të organizohet me një fëmijë, si një orë individuale, ose me një grup të vogël fëmijësh.

Materialet e nevojshme:

- Një kopje e figurës së shkallëve paralele të arushave për çdo pjesëtar të grupit, duke përfshirë të rriturit (shikoni Shtojcën 3)
- Lapëstila ose lapsa me ngjyra

Kërkojuni të gjithëve që t'i vështrojnë arushat me kujdes dhe të shohin se çfarë po bëjnë ata. Inkurajojini fëmijët që të thonë nëse arushat duken të lumtur, të mërzitur, të shqetësuar, të vetmuar, çapkënë etj. Ftojini fëmijët të japin shpjegime se përse mendojnë që një arush i caktuar ndihet ashtu siç duket.

Kërkojuni fëmijëve që të zgjedhin një ngjyrë dhe të ngjyrosin arushin në vend të të cilit do të dëshironin të ishin. Jepuni mundësi fëmijëve që të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Pastaj kërkojuni që të zgjedhin një ngjyrë tjetër dhe të ngjyrosin arushin në vend të të cilit nuk do të dëshironin të ishin apo atë për të cilin u vjen keq.

Hapni diskutime, pasi fëmijët nuk do të përzgjedhin të gjithë të njëjtin arush, dhe lejojeni bashkëbisedimin të rrjedhë duke vënë theksin në të dëgjuarin e të tjerëve dhe në të folurit me radhë. Nëse ju premtan koha, lëri fëmijët të ngjyrosin të gjithë figurën dhe ekspozojini ato në një tabelë që të tjerët t'i shikojnë.



KAPITULLI

4

Këshilla kryesore për krijimin e një ambienti loje sfidues

Planifikimi i lojës

Gjashtë gjërat për t'u bërë sa herë që
planifikohet dhe jepet mësim

Organizimi i lojës

Personeli menaxhues

Përdorimi i burimeve përjashta

Organizimi i pajisjeve për lojën përjashta

Vëzhgimi i sjelljes



Ky kapitull paraqet, në një format të përmbledhur, disa ide të cilat mund t'i merrni në konsideratë kur planifikoni një lojë sfiduese dhe ambientet e të nxënit. Mënyra se si ju e bëni organizimin e kësaj është kyç për të nxënë dhe zhvillimin e fëmijëve. Disa nga pyetjet që mund t'i bëni vetes janë si më poshtë:

Si mundem unë:

- të mbështes dhe zgjeroj të nxënë të tjerë edhe pse planifikoj aktivitete loje?
- t'i ndihmoj fëmijët të jenë spontanë?
- të zgjeroj gjuhën dhe komunikimin e fëmijëve nëpërmjet lojës?
- t'i ndihmoj fëmijët të kuptojnë botën që i rrethon?
- t'i bëj fëmijët të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe sfidat që paraqet bota (veçanërisht ajo jashtë)?
- të sigurohem që fëmijët do t'i provojnë gjërat në rrethana të sigurta?


Është e qartë që do të ketë disa kufizime për disa ambiente për sa i përket aksesit në hapësirën e oborrit. Por, edhe në këto raste, ka disa sugjerime më poshtë që mund të jenë të dobishme nëse doni të sillni një pjesë të aktiviteteve përjashta në ambientet e brendshme. Loja në Stadin Bazë është faktori më i rëndësishëm kur bëhet planifikimi i kurrikulës dhe e gjitha mund t'u mësohet fëmijëve përjashta!





Këshilla kryesore për planifikimin e lojës

- Sigurohuni që aktivitetet e planifikuara të kenë lidhje me eksperiencat e fëmijëve
- Kur planifikoni aktivitete për të ndërtuar koncepte të tilla si përmasat, forma, lartësia, pesha, merrni në konsideratë sa më shumë që të jetë e mundur organizimin e aktivitetit përjashta
- Bëjini këto aktivitete sa më argëtuese që të jetë e mundur, p.sh. gjeni krimbin më të gjatë, kërmillin më të madh, gurin më të rëndë, pellgun më të thellë
- Kur planifikoni aktivitete krijuese, merrni në konsideratë përdorimin e formave të natyrës, p.sh. gjethet, petalet, rrjetat e merimangave, guaskat, pendët
- Kur planifikoni me personelin tuaj – sigurohuni që të gjithë në personel të jenë entuziastë lidhur me punën në mjediset e jashtme
- Përdorni rregulla shumë të dukshme përjashta që fëmijët të dinë se çfarë pritet prej tyre
- Bëni një tabelë të orarit me figura (të plastifikuar, për ta mbrojtur nga ndryshimet e motit) dhe ekspozojeni atë
- Planifikoni hapësira të ndryshme dhe ndajini mjediset jashtë dhe brenda p.sh. zonat e qeta përjashta, zonat e vrapit dhe flakjes, zonat e gjurmimit, zonat e ndërtimit, zonat shqisore, zonat kreative, zonat e lojës simuluese
- Planifikoni aktivitete që janë të mundura të organizohen si në mjediset e brendshme ashtu edhe në mjediset e jashtme në mënyrë që fëmijët të mos bëjnë një dallim të ndërgjegjshëm midis ‘të mësuarit, që ndodh në mjediset e brendshme me praninë e një të rrituri’ dhe ‘lojës, që bëhet përjashta me shokët’.



Gjashtë gjërat për t'u bërë sa herë që planifikohet dhe jepet mësim

- Identifikoni objektivat e mësimit dhe ndajini ato me fëmijët
- Specifikoni sjelljen ekzakte që pritet prej fëmijëve
- Jepni udhëzime të qarta
- Përcaktoni kriteret e suksesit
- Përdorni shpërblimin – lavdërimet
- Përcaktoni çfarë mbështetjeje do të përdorni, p.sh. do të demonstroi fillimisht aktivitetin në mënyrë që fëmijët të dinë çfarë të presin, do të përdorni stimuj fizikë





Këshilla kryesore për organizimin e lojës

- Kufizime të tilla si faktorët e shëndetit dhe sigurisë dhe hapësirat në dispozicion do të ndikojnë, por merrni në konsideratë krijimin e një zone të mbjellë me bimë në mjediset e brendshme
- Vendosni saksi nëpër dritare
- Kërmillat dhe krimbat mund të mbahen shumë mirë edhe në hapësirat e brendshme nëse ju mungojnë oborret
- Rrisni bimë (lule dhe zarzavate) në parvazet e dritareve ku bie dielli
- Varni aparate për matjen e sasisë së shiut në një çengel pranë dritares
- Varni kuti me ushqim për zogjtë pranë dritares
- Ngjisni mullinj ere në kornizat e dritareve
- Kërkojuni prindërve që të dhurojnë rroba për kohë të lagësht
- Vendosni çengela për të varur rrobat që janë për përjashta në lartësinë e fëmijëve pranë daljes në mënyrë që fëmijët të mund t'i marrin vetë
- Mbajini sendet e vogla siç janë xhamat zmadhues gati për përdorim dhe në një vend prej nga fëmijët të mund t'i marrin vetë
- Vendosni kuti të mëdha plastike me kapakë për të magazinuar pajisjet brenda dhe jashtë – etiketojini me një figurë dhe një fjalë
- Lidhni mjedisin jashtë me atë brenda me një zonë të mbuluar dhe organizojini si një mjedis i vetëm të nxëni
- Përdoreni në mënyrë të natyrshme hapësirën përjashta për të organizuar kohën e përrallave, kohën në grup, vizatimin, numërimin, shkrimin etj.





Këshilla kryesore për personelin menaxhues

- Sigurohuni që të gjithë në personel janë entuziastë dhe të inkurajuar për të punuar në mjediset jashtë
- Personelit duhet t'i jepet një informacion i përmbledhur dhe duhet sqaruar mbi arsyet për të cilat kryhen aktivitetet (qëllimi i detyrës është numërimi/kujdesi për ambientin etj.?)
- Personeli ka nevojë për qëllime dhe objektiva specifike mësimdhënieje dhe duhet t'i ndajë ato me fëmijët
- Anëtarët e personelit duhet të jenë shembuj të aftësive të gjuhës/sjelljes/ndërveprimit
- Duhet të pritet nga fëmijët që të bëjnë punën e tyre (sa kartolina për Festën e Mamasë prodhohen nga të rriturit?)
- Personeli duhet t'i inkurajojë fëmijët të jenë të pavarur
- Personeli ka nevojë për trainim dhe azhurnim të vazhdueshëm, përfshirë çështjet e shëndetit dhe sigurisë
- Personeli i ri apo vullnetar duhet të marrë një trainim hyrës që të përfshijë edhe një tabelë që përcakton të gjitha mënyrat e pritura të sjelljes





Këshilla kryesore për përdorimin e burimeve përjashta

- Përdorni gura të mëdhenj ose trungje pemësh si blloqe natyrore për t'u ngjitur, degë apo trungje pemësh të prerë si karrige (kontrolloni sigurinë), guriçka, copa shkëmbinjsh, copa të vogla druri dhe guaska për të inkurajuar eksplorimin e materialeve natyrore
- Ndërtoni hapësira loje me rërë dhe ujë përjashta ku çdo rrëmujë mund të pastrohet lehtësisht
- Inkurajojini fëmijët që të kujdesen për pemët dhe bimët duke rritur lule vjetore (p.sh. purqarkë), zarzavate (p.sh. sallatë jeshile, rrepa) dhe erëza (p.sh. majdanoz). Fëmijët mund të korrin dhe të hanë produktet e sallatës. Nëse hapësira është e kufizuar, këto mund të mbillen në legenë apo në saks. Në vjeshtë mbillni bulbe që fëmijët t'i shikojnë të lulëzojnë në pranverë
- Mbani lule për ambiente të brendshme në vazo, tek parvazet e dritareve, dhe inkurajojini fëmijët që t'i ujisin me radhë
- Rrisni bimë përjashta për të tërhequr zogjtë dhe insektet, p.sh. lule vjollca për të tërhequr fluturat. Fëmijët mund të përdorin xhama zmadhues për të studjuar insektet e vogla
- Varni kuti me ushqim për zogjtë në pemë dhe në çengela dhe vendosni një shatërvan të vogël për zogjtë për t'i nxitur zogjtë e kopshtit të vijnë për t'u larë. Kërkojuni fëmijëve që të ndihmojnë për të rimbushur kutiçkat me ushqimin e zogjve dhe, kur bën ftohtë, të sigurohen që shatërvani nuk ka ngrirë
- Krijoni një pellg të vogël dhe mbani peshq në të (sigurohuni që të jetë i mbuluar me një rrjetë mbrojtëse që fëmijët të mos rrezikojnë të bien brenda!)
- Mblidhni materiale ndërtimi si kutia kartoni, copa druri etj. Këto mund të përdoren për lojëra simuluese me imagjinatë



Këshilla kryesore për organizimin e pajisjeve për lojën përjashta

- Mbani një koleksion rrobash dhe këpucësh për kohë të lagësht për rastet kur bie shi i imët apo kur toka është e lagur gjatë lojës përjashta. Një koleksion rrobash ekstra është gjithashtu i dobishëm për rastet kur moti bëhet i ftohtë papritur
- Ndërtoni një shtëpi të madhe kukulle, një strehë apo tenda që fëmijët të mund t'i përdorin si një fokus për lojërat me simulim
- Inkurajoni ndërgjegjësimin për motin duke mbajtur në dispozicion balona, mullinj ere apo shirita për ditët me erë si dhe matës të sasisë së shiut për të mbledhur shiun
- Mblidhni pajisje kopshtari, p.sh. ujitëse dhe mistri të vogla të përshtatshme për t'u përdorur nga duar të vogla
- Inkurajoni aktivitetet fizike në ambientet jashtë duke vënë në dispozicion litarë për t'u hedhur, topa (prej sfungjeri dhe plastikë), tunele për t'u zvarritur, lodra me rrota, një kalë druri lëkundës etj.
- Për aktivitete vizatimi në shkallë të gjerë siguroni një koleksion furçash të mëdha (si ato që përdoren për të lyer shtëpinë) dhe materiale mbi të cilat mund të pikturohet, p.sh. copa të mëdha kartoni, çarçafë të vjetër, faqe muri
- Krijoni një teatër kukullash
- Bëni një tabelë shkumësi përjashta
- Mblidhni tenxhere e tiganë të vërtetë, ibrikë dhe telefona për këndin e shtëpisë



Këshilla kryesore për vëzhgimin e sjelljeve

Një nga mënyrat më efektive për të vëzhguar lojën e një fëmije të vetëm është përdorimi i një tabele për vëzhgimin e kohës (shikoni regjistrimin e Vëzhgimit bosh në Shtojcën 1).

Vëzhguesi shikon nga një pikë jo shumë afër fëmijës por në një distancë të mjaftueshme për të dëgjuar ndërveprimet verbale që fëmija mund të ketë me të tjerët. Duke përdorur akrepin e gjatë të orës për të matur minutat, vëzhguesi bën një shenjë në tabelë në fund të çdo minute për një periudhë kohe të caktuar p.sh. 5 minuta, 10 minuta, 20 minuta etj. Nëse fëmija është në detyrë e sipër atëherë shenja mund të vihet në kutinë e sjelljes ‘në detyrë’ – nuk ka rëndësi se çfarë lloj detyre është duke bërë – për aq kohë sa ai do të vazhdojë ta bëjë atë! Shënime të tjera bëhen në tabelë sa herë që shfaqet ndonjë sjellje tjetër, p.sh kur flet me fëmijët e tjerë ose të rriturit, vjen vërdallë, shikon në hapësirë, pushton hapësirën e një fëmije tjetër.

Disa vëzhgime të shkurtra të marra çdo ditë për një javë mund të jenë shumë informuese kur jeni të shqetësuar për mungesën e ecurisë së një fëmije ose edhe nëse jeni të shqetësuar për disa nga aktivitetet që po ofroni dhe doni të dini se në ç’mënyrë (apo nëse) këto aktivitete ofrojnë një eksperiencë loje stimuluese.

Ky regjistrim i shkurtër grafik i Vëzhgimit, i plotësuar për disa periudha të shkurtra kohe, ndonjëherë mund të ofrojë një ide të përgjithshme më të mirë për një fëmijë se sa një ditar i gjatë, i pandërprerë për lëvizjet e fëmijës në këndin e lojërave (shikoni shembullin e regjistrimit të Vëzhgimeve, plotësuar për Xhon Brigs në Shtojcën 1).

Vëzhgimi një herë në javë për rreth një muaj mund të ndihmojë gjithashtu për të kapur modele të sjelljes së fëmijës. Disa fëmijë duket se asnjëherë nuk hyjnë në ngatërresa, por aktualisht e kalojnë shumicën e kohës duke u endur, duke iu shmangur shoqërizimit me fëmijët e tjerë, duke shmangur aktivitete të caktuara, duke pasur një ndërveprim të mirë shoqëror me bashkëmoshatarët, por jo me të rriturit (ose e kundërta) ose krijojnë shumë varësi ndaj të rriturve etj. Kjo lloj njohurie për fëmijën mund të jetë shumë e vlefshme kur takoheni me prindërit/kujdestarët ose kur planifikoni fazën tjetër të edukimit të tyre.



SHTOJCA

1

Paketa e regjistrimit

PEI – Beni

PEI – Milo

PEI – Bosh

Tabela e vëzhgimit

Regjistrimet e vëzhgimit – bosh

Regjistrimet e vëzhgimit – shembull



PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL

EMRI: DATËLINDJA: KOPSHTI:

PLANI NR.: NDËRHYRJA/NDËRHYRJAPLUS DATA:

FUSHAT PËR T'U ZHVILLUAR:

OBJEKTIVAT:	STRATEGJITË, BURIMET, KONTRIBUTET
1	
2	
3	

PERTU ARRITUR DERINË:
FIRMA

KOORDINATORI:

DATA E RISHIKIMIT:
PRINDI/KUJDESTARI:

RISHIKIMI

1

2

3

NDËRHYRJET E ARDHSHME

FIRMA

KOORDINATORI:

PRINDI/KUJDESTARI:

[illegible]

PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL

EMRI: □□□□ **DATËLINDJA:** **KOPSHTI:**
PLANINR.: **NDËRHJRJA/NDËRHJRJA PLUS DATA:**
FUSHAT PËR T'U ZHVILLUAR: □□□□□□□□ □□□ □□□□□□□□

OBJEKTIVAT:	STRATEGJITË, BURIMET, KONTRIBUTET
1	
2	
3	

PER T'U ARRITUR DERINË: DATA E RISHIKIMIT:
FIRMA KOORDINATORI: PRINDI/KUJDESTARI:

RISHIKIMI

1
2
3

NDËRHJRJETE ARDHSHE

FIRMA KOORDINATORI: PRINDI/KUJDESTARI:

TABELA E VËZHGIMIT

Emri: _____ **Datëlindja:** _____ **Java e fillimit:** _____
Parashkolla: _____

Orari	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
9.00 – 9.15					
9.15 – 9.30					
9.30 – 9.45					
9.45 – 10.00					
10.00 – 10.15					
10.15 – 10.30					
10.30 – 10.45					
10.45 – 11.00					
11.00 – 11.15					
11.15 – 11.30					
11.30 – 11.45					
11.45 – 12.00					
12.00 - 12.15					
12.15 – 12.30					
12.30 – 12.45					
12.45 – 1.00					
1.00 – 1.15					
1.15 – 1.30					
1.30 – 1.45					
1.45 – 2.00					
2.00 – 2.15					
2.15 – 2.30					
2.30 – 2.45					
2.45 – 3.00					

Në detyrë, i kënaqur, i sjellshëm 5

Në detyrë 4

Jashtë detyrës/i heshtur/s'pranon të përgjigjet 3

Jashtë detyrës/i dhunshëm me fjalë 2

Jashtë detyrës/i dhunshëm fizikisht 1



REGJISTRIMI I VËZHGIMIT

Emri: Datëlindja: Vëzhguar nga:

Parashkolla:

Data dhe ora	Sjellja në detyrë	Sjellja jashtë detyrë – i qetë	Sjellja jashtë detyrë - shqetësues					

Komentet:

REGJISTRIMI I VËZHGIMIT

Emri: Xhon Brigs **Data lindja:** Vëzhguar nga ^{dhuli Endrius - Punonjësja kryesore}

Parashkolla: Synnyside

Data dhe ora	Sjellja në detyrë	Sjellja jashtë detyrë – i qetë	Sjellja jashtë detyrë - shqetësues						Fshihet në garderobë
			Rrëmben lodrat të tjerëve	Hedh rërë/ lodrat etj.	Vrapon përreth dhomës	Ulëret një fëmije tjetër	Ulëret një të rrituri	Injoron udhëzimet	
4/10/04									
10.00–10.10	4444	1	11	1	11	1	1	1111	
1.00–1.10 koha e zemrës	4444 1111	1						1	
2.20 – 2.30 koha e pastrimit	11		111	4444	11	11	11	4444	1

Komentet: Xhoni pati vështirësi përqendrimi në të gjitha aktivitetet këtë mëngjes. Periudhat e tij më të gjata të përqendrimit ishin 1) kur po luante me Sonin në govatën e rërës dhe 2) kur po ndihmonte në shpërndarjen e frutave dhe lëngjeve në kohën e zemrës




SHTOJCA

2

Rrethi i miqve dhe
familjes – bosh




Rrethi i miqve dhe familjes – bosh



SHTOJCA

3

Aktiviteti i shkollëve
paralele të arushave -
bosh



REFERENCAT

Drake, J. (2005) *Planifikimi i Lojës dhe të Nxënës të Fëmijëve në Fazën Bazë* (bot. i 2-të). Londër :David Fulton Publishers

Glenn, A., Cousins, J. Dhe Helps, A. (2004) *Sjellja në Vitet e Hershme*. Londër: David Fulton Publishers

Glenn, A., Cousins, J. dhe Helps, A. (2005) *Eliminimi i Pengesave në të Nxënë në Moshën e Hershme*. Londër: David Fulton Publishers

Drejtorja e Kurrikulës dhe Kualifikimit (DKK) (2000) *Udhëzues i Kurrikulës për Fazën Bazë*. Londër: QSA

LEXIME TË TJERA

Bilton, H. (2004) *Loja Përjashta: Aktivitete, ide dhe frymëzim për moshën e hershme*. Londër: David Fulton Publishers

Broadhead, P. (2003) *Loja dhe të Nxënët në Moshën e Hershme: Zhvillimi i aftësive shoqërore dhe bashkëpunimit*. Oksford: RoutledgeFalmer

Daly, M. (2005) *Zhvillimi i Fëmijës në Tërësi: Rëndësia e aspekteve emocionale, sociale, morale dhe shpirtërore në edukimin dhe kujdesin për moshën e hershme*. Lewiston: Edwin Meller Press.

Drifte, C. (2003) *Udhëzues për Ofrimin e Nevojave të Veçanta në Edukim në Parashkolla*. Londër: David Fulton Publishers

Green, S. (2004) *Kreativiteti*. Londër: David Fulton Publishers

Green, S. (2004) *Ushqime dhe Gatime*. Londër: David Fulton Publishers

Green, S. (2005) *Libra, Tregime dhe Kukulla*. Londër: David Fulton Publishers

Green, S. (2005) *Loja e Roleve*. Londër: David Fulton Publishers

Green, S. dhe Harper, S. (2005) *Natyra*. Londër: David Fulton Publishers

Hewitson, C. (2004) *Festivalet*. Londër: David Fulton Publishers

Mortimer, H. (2000) *Hartimi i Planeve Individuale të Sjelljes në Moshën e Hershme*. Tamworth: NASEN

Papatheodorou, T. (2005) *Problemet e Sjelljes në Moshën e Hershme: Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme*. Oksford: RoutledgeFalmer.

Tassoni, P. (2000) *Planifikimi i Lojës dhe Mosha e Hershme*. Oksford: Heinemann.

Adresa të nevojshme

Shoqata Britanike e Terapistëve Artistikë
24-27 Lion Street
London N19PD
Tel: 020 7686 4216
www.baat.org

Shoqata Britanike e Terapistëve të Lojës
31 Cedar Drive
Keynsham
Bristol BS31 2TY
Tel: 0117 9860390
www.bapt.info

Cruse Bereavement Care
Cruse House
126 Sheen Road
Richmond
Surrey TW9 1UR
Tel: 020 8936 9530
www.rusebereavementcare.org.uk

High/Scope UK
190-192 Maple Road
London SE20 8HT
Tel: 0208676 0220
www.high-scope.org-uk

Shoqata Kombëtare Autiste
393 city Road
London ECIV ING
Tel: 020 7833 2299
Email: nas@nas.org.uk

Aleanca për të Nxënët Parashkollor
69 Kings Cross Road
London WCIX 9LL
Tel: 020 7833 0991
www.pre-school.org.uk

Smallwood Publishing Ltd
The Old Bakery
Charlton House
Dour Street
Dover
Kent CT16 1ED
Tel: 01304 226900
www.smallwood.co.uk

Strategji të provuara dhe testuara: Loja dhe të Nxënët në Moshën e Hershme

Loja është vendimtare në zhvillimin e çdo fëmije. Përdorini këto strategji praktike për të siguruar që të gjithë fëmijët të përfitojnë nga të nxënët nëpërmjet lojës

Përfshin:

- Raste të shkurtra studimore që demonstrojnë se si strategjitë funksionojnë në praktikë
- Informacion praktik sipas temave mbi si mund t'i përfshijmë të gjithë fëmijët në aktivitetet e përditshme
- Shpjegim mbi mënyrat se si tipe të ndryshme Nevojash të Veçanta në Edukim mund të ndikojnë lojën e fëmijës
- Këshilla mbi si të adresohen sjellje të ndryshme të shfaqura gjatë lojës
- Burime të fotokopjueshme

Lëvdata për librin e parë të serisë 'Të Provuara dhe Testuara',
Sjellja në fëmijërinë e Hershme

'Libri mbi Sjelljen m'u duk i shkëlqyer! Të gjithë anëtarët e personelit tim e lexuan. Është i lehtë dhe i shpejtë për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar. Ne jemi duke përdorur disa nga formatet dhe shpesh u kthehemi shembujve të dhënë.'

Maria Hill dhe Sue Copping, Supervizore dhe Koordinatorë të Nevojave të Veçanta të Edukimit në Aleancën e të Nxënët Parashkollor të St. Luke.

Shkruar për specialistët në të gjitha ambientet parashkollore, kujdestarët e fëmijëve dhe prindërit.

Autorët

Angela Glenn është një Mësuese Këshilluese në Medway ICSS

Jacque Cousins është menaxhere në Njësinë e Referimit të Nxënësve Fillestarë dhe gjithashtu ofron këshillim dhe training për personelin

Alicia Helps është një Psikologe e Edukimit

Strategji
të provuara
dhe testuara:
Loja dhe
të Nxënët
në Moshën
e Hershme

Angela Glenn,
Jacque Cousins
dhe Alicia Helps



David Fulton Publishers

www.fultonpublishers.co.uk

ISBN 1-84312-336-3



9 781843 123361